

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

JANAR - MARS 2005

Buletin 3-mujor /Nr. 11

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

1.1 Asistencë nëpërmjet ekspertizës dhe oponencës ligjore

a) Oponenca ligjore për përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të miturit

1.2 Asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh

- a) Sesioni i katërt i punës në kuadrin e asistencës teknike ofruar administratës të burgjeve shqiptare
b) Këshillim ligjor lidhur me reformat në burgje

2. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

2.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase dhe të huaja

- a) Takime me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë për përmirësimin e legjislacionit për të miturit
b) Takime me përfaqësues të Komisionit Qëndror Zgjedhor
c) Forcimi i bashkëpunimit në rajon

3. PROJEKTE TË REJA

4. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJVE JANAR – MARS 2005

4.1 Publikime

a) E drejta e shërbimit ligjor falas në Shqipëri

4.2 Raporte

4.3 Raport për të drejtat e njeriut për Shqipërinë,

5.1 Respektimi i të drejtave të emigrantëve

5.2 Tryeza të rumbullakëta

a) Përmirësimi I sistemit të drejtësisë për të miturit

b) Paraqitja e raportit si rezultat I vëzhgimeve të KSHH-së lidhur me respektimin e të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve”

c) Reforma zgjedhore dhe shoqëria civile në këtë proces

6 REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

7 SHTETASIT I DREJTTOHEN KSHH-SË

7.1 Ankesat e qytetarëve

7.2 Raste të verifikuara nga KSHH

8 KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE DHE ORGANIZATA

9 KSHH DHE MEDIA

9.1 Emisione në TV

9.2 Pasqyrimi i aktiviteteve të KSHH-së në media

10 NGRITJE KAPACITETESH TË VETË ORGANIZATËS

10.1 Trajnime dhe seminare trajnuese për stafin e KSHH-së

a- Trajnim për korrespondentët e KSHH-së

b- Trajnim të vëzhguesve të KSHH-së për zgjedhjet

c- Seminar trajnues në Ohër, Maqedoni

d- Seminari trajnues “Ngritje fondesh të vetë organizatës”,

10.2 Pjesëmarrje e KSHH-së në aktivitete të ndryshme

ANEKS Nr. 1 - DEKLARATA

5 TRYEZA DHE KONFERENCA

**Rr: “Gjin Bue Shpata”, Pall. 5/1; Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752, Tel: 04 233671; 04229002
Fax: 04 233671; CEL: 068 20 23699; E-mail: office@ahc.org.al; web-site: www.ahc.org.al**

1. VEPRIMTARI TRAJNUESE DHE OFRIM EKSPERTIZE

1.1 Asistencë nëpërmjet ekspertizës dhe oponencës ligjore

a) Oponenca ligjore për përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të miturit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) gjatë muajit janar është angazhuar në bërjen e oponencës ligjore për projektaktet e legjislacionit të të miturve. Në këtë kuadër KSHH ka dhënë rekomandimet e tij lidhur me çështje të ndryshme ligjore të projektpropozimit për legjislacionin e të miturve.¹

KSHH vuri më shumë theksin tek çështjet e ligjit material, ligjit procedural dhe masat që duhet të marri shteti në të ardhmen për të zbatuar dispozitat ligjore në praktikë.

Ndër çështjet më të rëndësishme që KSHH ka trajtuar janë: mospranimi i rritjes së kufirit të moshës për përgjegjësi penale, nevoja e ngritjes së seksionit që duhet të gjykojë të miturit, dënimet alternative për të miturit, masat mjekësore dhe edukuese, infrastruktura në vëndet e paraburgimit dhe burgje, specializimi i gjyqtarëve dhe i organeve të tjera gjyqësore, etj.,

Përfundimet e oponencës ligjore të paketës së propozuar nga ekspertët, KSHH i paraqiti dhe në tryezën e përbashkët të organizuar me Ministrinë e Drejtësisë dhe UNICEF².

1.2 Asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh

a) Sesioni i katërt i punës

Në kuadër të veprimtarisë së KSHH-së për përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe asistencës teknike, KSHH ka zhvilluar veprimtari trajnuese dhe ka ofruar ekspertizë për sistemin e burgjeve shqiptare.

Në datat **21-22 Shkurt 2005**, u organizua **sesioni i katërt i punës** në ambjentet e Burgut të Peqinit. Ky sesion kishte si objektiva kryesore dhënien e asistencës dhe ekspertizës lidhur me strukturën organizative dhe të komunikimit të këtyre dy burgjeve pilot dhe finalizimin e projektit përfundimtar të Rregullores së Brendshme të burgut të Peqinit. Ekspertiza u ofrua nga dy ekspertë të huaj të KSHH-së përkatësisht Z. Jan van den Brand³, dhe Z. Kejs Boeij⁴.

Ekspertët i njohën pjesëmarrësit me komentet dhe sugjerimet e tyre konkrete për këtë rregullore duke e shqyrtuar atë nga këndvështrimi i standarteve ndërkombëtare sidomos me Rregullat Europiane të Burgjeve. Aktualisht Rregullorja i është dorëzuar Ministrisë së Drejtësisë për miratim.

Një problem i trajtuar ishte vizioni dhe qëllimet e institucioneve të tyre, mënyrat e arritjes së tij, si dhe dhënia e modeleve të ndryshme të strukturave organizative dhe të komunikimit të këtyre institucioneve në Europën Perëndimore, Lindore dhe Qendrore mbi bazën e të cilave u analizuan institucionet penitenciare shqiptare. Ekspertët trajtuan disa situata konkrete të punës së përditshme në një institucion riedukimi, procedurat standarte që duhen ndjekur në situata të grevave kolektive të urisë në një burg, raste të vetvrasjeve ose të vdekjeve natyrore të një të dënuari në burg, raste kur një i dënuar nuk kthehet pas lejes së dhënë nga administrata e burgut, etj.

Në këtë aktivitet, morën pjesë dhe ndihmuan me pjesëmarrjen e tyre Z. Hasan Ahmetaj, Zëv/Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve (DPB), përfaqësues të lartë të DPB-së, përfaqësues të

¹ Projektpropozimi është kryer nga një grup ekspertësh të Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur financiarisht nga UNICEF

² Më hollësisht lidhur me tryezën shih pjesën 5.2, a) të këtij buletini

³ Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Agjencinë Kombëtare Hollandeze të institucioneve të Riedukimit si edhe në të njëjtën kohë ekspert i Këshillit të Europës për Europën Qendrore dhe Lindore

⁴ Drejtor i Përgjithshëm me një detyrë të veçantë për hartimin e amendamenteve të legjislacionit penal në Hollandë

sektorit të sigurisë dhe të edukimit të këtij institucioni, drejtuesit dhe stafi i lartë i dy burgjeve pilot, Peqin dhe Rrogozhinë. Në përfundim, pjesëmarrësit, ekspertët e huaj dhe përfaqësuesit e KSHH-së e vlerësuan këtë aktivitet të sukseshëm për objektivat e vendosura ku teoria dhe praktika u kombinuan natyrshëm⁵.

b) Këshillim ligjor lidhur me reformat në burgje

Duke filluar nga Janari 2005, ekspertë të huaj të angazhuar nga KSHH kanë bërë të mundur ofrimin e këshillimeve drejtuesve të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) lidhur me reformimin e këtij institucioni. Seancat këshillimore janë bazuar në nevojat e DPB-së⁶ duke dhënë sugjerime dhe modele për çështje të ndryshme. Ndër to mund të përmendim masat që duhet të ndërmerren institucionet kompetente lidhur me mekanizmin e ankesave dhe kërkesave të të dënuarve, në mënyrë që ky mekanizëm të funksionojë në interes të të dënuarve; sugjerime dhe modele lidhur me punësimin dhe arsimimin e të dënuarve, të cilat përbëjnë edhe prioritetet e DPB-së për vitin 2005.

Këto seanca këshillimore⁷ janë vlerësuar si të domosdoshme për DPB-në dhe shumë frytëdhënëse nga vetë drejtuesit e lartë të këtij institucioni.

2. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

2.1 Takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve vendase dhe të huaja

a) Takime me përfaqësues të Ministrisë e Drejtësisë për përmirësimin e legjislacionit për të miturit

Gjatë muajit janar 2005, KSHH ka organizuar një sërë takime me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe UNICEF lidhur me projektpropozimin për legjislacionin për të miturit si dhe për rekomandimet që KSHH ka paraqitur në opionencën e legjislacionit për të miturit.

Në këto takime janë trajtuar probleme të legjislacionit të të miturve si dhe të zbatimit në praktikë të tyre si dhe u diskutua për një tryezë të përbashkët për drejtësinë për të miturit. KSHH ka organizuar një sërë takime me përfaqësues të organizatave vendase dhe atyre ndërkombëtare, si OSBE, Qendra për nismat ligjore (Qendra Avokatore e Grave), Klinika ligjore për të miturit, etj.⁸

b) Takime me përfaqësues të Komisionit Qëndror Zgjedhor

Me qëllim të përmirësimit të procesit për përgatitjen e zgjedhjeve parlamentare 2005, përfaqësues të KSHH-së kanë kryer takime me përfaqësues të KQZ-së, për problemet dhe çështjet e ndryshme që janë paraqitur lidhur me reformën zgjedhore dhe me zhvillimin e procesit parazgjedhor të zgjedhjeve parlamentare 2005.

Ndër çështjet më të rëndësishme që kanë gjetur diskutim gjatë këtyre takimeve kanë qënë kodi zgjedhor, ngritja e KZZ-ve, shpallja e listave në kohën e duhur, data e zgjedhjeve, etj. KSHH është treguar i gatshëm për të dhënë kontributin e tij lidhur me problemet e të drejtave të njeriut.⁹

⁵ Ky aktivitetet është bërë në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁶ Në këto seanca këshillimore është angazhuar nga KSHH, z. Jan van den Brand, ekspert hollandez me shumë përvojë në drejtimin e institucioneve penitenciare, njohës i mirë i sistemit penitenciar shqiptar si dhe ekspert i Këshillit të Evropës për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

⁷ Ky aktivitetet është bërë në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

⁸ Këto aktivitete janë mbështetur financiarisht nga projekti “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, Komiteti Suedez i Helsinkit

⁹ Takimet janë bërë në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, Komiteti Suedez i Helsinkit

c) Forcimi i bashkëpunimit në rajon

Në datat 4 – 7 Shkurt 2005 u zhvillua Asambleja e Përgjithshme¹⁰ e Ballkan Human Rights Netëork, në Igalo, Mal i Zi. Në kuadër të forcimit të bashkëpunimi në rajon në këtë rrjet ballkanik bën pjesë dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Në mbledhjen e kësaj here u bënë disa ndryshime në statutin e këtij rrjeti, si dhe ndryshime në përbërjen e anëtarëve të Komitetit Drejtues dhe të Komitetit Vlerësues.

Prioritetet e kësaj mbledhje ishin programet e edukimit ligjor të të rinjve dhe komunitetit, respektimi i të drejtave të minoriteteve, respektimi i të drejtave ekonomike, social-kulturore si dhe respektimi i të drejtave politike dhe civile, shteti ligjor dhe qeverisja e mire.

3. PROJEKTE TË REJA

3.1 Projekti “Ngritja e kapaciteteve të organizatës dhe forcimi i organizimit të brëndshëm”, mbështetur financiarisht nga CORDAID

Në kuadër të mbështetjes së dhënë nga CORDAID (Catholic Organization for Relief and Development), gjatë kësaj periudhe vëmendje i është kushtuar rritjes së bashkëpunimit me organizatat e të drejtave të njeriut, vendase dhe të huaja, rritjes së pranisë së KSHH-së në mjedisin shqiptar si dhe rritjes së kapaciteteve të stafit.

Këto objektiva janë realizuar nëpërmjet një sërë veprimtarive të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur në faqen e këtij buletini.

KSHH-ja ka zgjeruar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me organizata të tilla si: UNICEF, OSBE, Greek Helsinki Monitor dhe me organizata të tjera vendase. Një pjesë e mirë e takimeve janë zhvilluar për probleme të rëndësishme si përgatitja e procesit zgjedhor, përmirësimi i legjislacionit në fushën e drejtësisë dhe asaj të burgjeve, një vëmendje më të madhe ndaj të drejtave të emigrantëve.

Oponenca për ligje dhe zbatimin e tyre kanë zënë një vend të veçantë në veprimtarinë e KSHH-së. Rekomandime për përmirësime të ligjit i janë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për shfuqizimin e një dispozite të Kodit zgjedhor e cila shfuqizon Kodin Zgjedhor menjëherë nxjerrjes së rezultateve të zgjedhjeve. Komisioni i ligjeve ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë dhe e ka kaluar në seancë parlamentare.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve të organizatës, janë zhvilluar trajnime të aktivitetëve të rinj të KSHH-së të cilën do të vëzhgojnë aspekte të veçanta të procesit zgjedhor; trajnim për ngritje fondesh, trajnim të stafit mbi kodin e ri zgjedhor.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit në rajon, dy anëtarë të KSHH-së (një anëtar i asamblesë dhe një anëtare e stafit) u trajnuan në fushën e mekanizmave mbrojtës të minoriteteve. Gjithashtu, KSHH-ja pati përfaqësuesin e vet në mbledhjen e përgjithshme të Ballkan Human Rights Network.

KSHH-ja ka përdorur gjerësisht median e shkruar dhe elektronike për të informuar dhe sensibilizuar publikun për aspekte të veçanta të të drejtave të njeriut.

¹⁰ Asambleja e Përgjithshme e BHRN-së zhvillohet një herë në dy vjet

3.2 Projekti “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve nga forcat e policisë kufitare shqiptare dhe greke” mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

Në kuadër të respektimit të të drejtave të emigrantëve KSHH ka filluar zbatimin e këtij projekti i cili synon ndërgjegjësimin e publikut për denoncimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të emigrantëve si dhe keqtrajtimit të tyre nga policia kufitare Greke si dhe lehtësimi i procedurave për zhvillimin e proceseve gjyqësore në shtetin grek.

Kjo veprimtari e ndërmarrë nga KSHH do të realizohet në bashkëpunim me Monitoruesin Grek të Helsinkit. Informacionet e përfuara për keqtrajtimin e emigrantëve shqiptarë do tu referohet autoriteteve shtetërore shqiptare dhe institucioneve ndërkombëtare.

3.3 Projekti “Së bashku për një shoqëri më demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut”, mbështetur financiarisht nga SOROS

Projekti ka filluar zbatimin e tij në janar 2005, dhe ka si objekt kryesor respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në nivel vendor nëpërmjet rrjetit të korrespondentëve të KSHH-së në 7 rrethet kryesore të vëndit (Vlorë, Gjirokastër, Kukës, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Fier).

Veprimtaria e tyre do të fokusohet në dy fusha kryesore, vëzhgimi i procesit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, vëzhgimi i respektimit të të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve, vëzhgimi i respektimit të të drejtave në fusha të ndryshme, etj.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, KSHH do të rrisë presionin dhe reagimin ndaj shkeljeve të kryera nga organet shtetërore vendore për një respektim më të mirë të drejtave të shtetasve në fusha të ndryshme.

4. PUBLIKIMET E KSHH-SË GJATË MUAJIT JANAR – MARS 2005

4.1 Publikime

a) Publikimi “E drejta e mbrojtjes falas në Shqipëri”¹¹

Së fundi, KSHH publikoi studimin “E drejta e mbrojtjes falas në Shqipëri”, në të cilin trajtohet legjislacioni për shërbimin avokator falas/kryesisht dhe studimi i praktikës së zbatimit të tij si dhe përfundimet e një anketimi që KSHH kreu në disa nga institucionet e sistemit të drejtësisë penale në Tiranë, respektimi i të drejtave të personave që kanë nevojë për këtë lloj mbrojtjeje, etj..

Ky botim është një kontribut modest në fushën e studimeve juridike dhe të përmirësimit të legjislacionit dhe të zbatimit të tij dhe mund të shërbejë për institucionet shtetërore që hartojnë politikat ligjore.

4.2 Raporte

a) Raport për të drejtat e njeriut për Shqipërinë i cili botohet çdo vit nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit¹²

KSHH pergatiti raportin “Për të drejtat e njeriut për Shqipërinë” i cili botohet çdo vit nga Federata Ndërkombëtare e Helsinkit.

¹¹ Publikimi është bërë në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, Komiteti Suedez i Helsinkit

¹² “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve nga forcat e policisë kufitare shqiptare dhe greke” mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

Në të bëhet një paraqitje e respektimit të të drejtave të njeriut në disa fusha më kryesore, si; vendet e paraburgimit dhe burgjet në Shqipëri, sistemi gjyqësor, reforma zgjedhore, shërbimi avokator falas, respektimi i të drejtave të minoriteteve, etj¹³.

5. TRYEZA DHE KONFERENCA

Një nga format e veprimtarisë së KSHH-së lidhur me përmirësimin e praktikës së zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të shtetasve janë konferencat dhe tryezat e rrumbullakta me tematika të ndryshme.

- **Respektimi i të drejtave të emigrantëve**

Konferenca për shtyp lidhur me situatën e respektimit të të drejtave të emigrantëve¹⁴

Në datën **23 shkurt 2005**, KSHH dhe Monitoruesi Grek i Helsinkit (GHM), organizuan një konferencë për shtyp lidhur me situatën e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi. Konferenca u organizua në të njëjtën kohë me procesin gjyqësor të emigrantit shqiptar Vullnet Bytyçi të vrarë nga policia kufitare greke, në Kostur të Greqisë.

Në këtë konferencë për shtyp përfaqësues të dy organizatave paraqitën një panoramë të gjëndjes së respektimit të të drejtave të emigrantëve në Greqi duke dhënë zhvillimet pozitive por njëkohësisht dhe problemet e hasura duke pretenduar se shqiptarët vazhdojnë të jenë objekt i diskriminimit shumëplanësh, e përcaktuar dhe në **Raportin e Tretë për Greqinë** (nxjerrë në Qershor 2004) nga Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI).

Organizatave dolën me një deklaratë të përbashkët lidhur me procesin jo të rregullt gjyqësor për vrasjen e Vullnet Bytyçit duke iu bërë thirrje autoriteteve greke që të shqyrtonin procedurën, të siguronin zhvillimin e një gjyqi të paanshëm me praninë e të gjithë dëshmitarëve si dhe të mbrojnë të drejtat e shqiptarëve para gjykatave greke për tu siguruar kështu një trajtim të drejtë si gjithë qytetarët europianë.

Gjithashtu KSHH dhe GHM shpërndanë një tjetër deklaratë në konferencën e organizuar nga IOM për hartimin e strategjisë kombëtare për emigrantët, në datën 21 shkurt 2005.

- **Përmirësimi i sistemit të drejtësisë për të miturit**

Tryeza e përbashkët e Ministrisë së Drejtësisë, Unicef dhe KSHH-së “Drejtësia për të miturit - e tashmja dhe perspektiva”¹⁵

Në datën 18 janar 2005, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, organizoi tryezën e rrumbullakët **“Drejtësia e të miturve – e tashmja dhe perspektiva”**.

Tryeza synonte të bënte publike marrjen e masave ligjore dhe masat për zbatimin e tyre në praktikë për përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të miturit.

Përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile dhanë disa nga rekomandimet e tyre lidhur me paketën ligjore të propozuar nga Ministria e Drejtësisë. Çështjet që u trajtuan në këtë tryezë ishin: ndryshimi i kufirit të moshës për përgjegjësi penale; dhënia e dënimeve alternative, trajtimi i kategorisë së personave 18 – 21 vjeç (jeune adult); masat edukuese dhe mjekësore, specializimi i

¹³ Mbështetet financiarisht nga CORDAID

¹⁴ Konferenca është realizuar në kuadër të projektit “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve nga forcat e policisë kufitare shqiptare dhe greke”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit

¹⁵ Kjo tryezë u realizua në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, Komiteti Suedez i Helsinkit

organeve gjyqësore; infrastruktura në vëndet e paraburgimit dhe në burgje, ruajtja e të miturve nga arrestimet e paligjshme; etj, të cilat u pasuan nga shumë diskutime të të pranishmëve.

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore që punojnë me të drejtat e të miturve që mbulojnë fushën legjislative dhe atë praktike të këtij objekt diskutimi si dhe përfaqësues të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të të miturve.

- **Respektimi i të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve**

“Paraqitja e raportit si rezultat i vëzhgimeve të KSHH-së lidhur me respektimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve”¹⁶

Në datën 9 Shkurt 2005, KSHH bëri publik raportin e dalë nga vëzhgimet e KSHH-së për respektimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve.

Pjesëmarësit pasi dëgjuan përfundimet e raportit të KSHH-së diskutuan lidhur me kuadrin ligjor dhe nënligjor që garanton të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve si dhe çështje të tjera si: kalimi i varësisë së vendeve të paraburgimit nga Ministria e Rendit Publik në Ministrinë e Drejtësisë, transferimi i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga vëndet e paraburgimit në burgje, infrastruktura dhe kushtet higjieno-sanitare në vëndet e paraburgimit dhe në burgje, ushqimi, shërbimi shëndetësor në këto institucione, informimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve lidhur me të drejtat e tyre, etj. Gjithashtu, raporti i paraqitur nga KSHH preku edhe probleme të cilat lidheshin me trajtimin e grupeve vulnerabël duke paraqitur dhe rekomandimet përkatëse për secilin problem të ngritur. Pjesëmarësit në këtë tryezë vlerësuan përfundimet e KSHH-së si objektive dhe të paraqitura me një kulturë profesionale.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të lartë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Rendit Publik, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Rrethit Tiranë, Avokati i Popullit, si edhe disa nga drejtuesit e institucioneve penitenciare të vëzhguara.

- **Reforma zgjedhore dhe shoqëria civile në këtë proces**

Tryeza e rumbullakët për reformën zgjedhore¹⁷

Në kuadër të nevojës që është paraqitur lidhur me reformën zgjedhore në datën 21 Mars 2005, KSHH organizoi një tryezë të rumbullakët për të diskutuar “Disa nga ndryshimet kryesore që i janë bërë Kodit zgjedhor”. Çështjet më të rëndësishme që u trajtuan në këtë tryezë ishin: koha e përgatitjes së listave të votuesve si dhe shpallja e tyre, personat përgjegjës për hartimin dhe korrigjimin e këtyre listave si dhe penalizimet në rast të shkeljeve të ndryshme, afatet për korrigjimin e listave, mënyra e votimit të studentëve që nuk banojnë në Tiranë, procesi i numërimit të votive, shqyrtimi i çështjeve që bëhen objekt gjyqësor, monitorimi i medias gjatë fushatës zgjedhore, procesi i financimit të zgjedhjeve, kërkesat për akreditimin e vëzhguesve vendas, etj.. Në këtë tryezë gjithashtu u bënë shumë diskutime dhe nga pjesëmarrësit lidhur me problemet e ngritura nga KSHH.

¹⁶ Ky tryezë u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

¹⁷ Kjo tryezë u realizua në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese”, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

Në të merrnin pjesë përfaqësues të autoriteteve shtetërore, përfaqësues të organizatave vendase dhe ndërkombëtare, ekspertë të kësaj fushe si dhe përfaqësues të medias së shkruar dhe asaj elektronike.

6. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (DEKLARATA PUBLIKE & NJOFTIME PER SHTYP)¹⁸

Gjatë periudhës janar – mars 2005, KSHH ka reaguar nëpërmjet **7 deklaratave publike** dhe **3 njoftimeve për shtyp** si dhe **një letër të hapur** drejtuar Kuvendit.

Reagimi i KSHH-së ka qënë kryesisht për probleme shqetësuese lidhur me kodin zgjedhor i cili kufizon akreditimin e vëzhguesve të OJF-ve, respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi, vonesën e krijimit të KZZ-ve dhe pasojave negative të tyre në procesin zgjedhor, vonesën e ngritjes së KZZ-ve dhe pasojat negative të vonesës së këtij procesi, me rastin e ditës kundër racizmit dhe diskriminimit racial, për incidente të ndryshme të ndodhura ai ajo në Greqi me rastin e ndeshjes Greqi-Shqipëri ku u gris flamuri shqiptar dhe u kryen veprime të tjera antishqiptare, etj.

Njoftimet për shtyp kanë patur si objekt dhënien e informacioneve të ndryshme për publikun e gjërë, sidomos rezultatet e vëzhgimeve në fusha të ndryshme, përfundime të studimeve dhe oponencave të ligjeve të ndryshme që KSHH ka realizuar, konkretisht prezantimin e drejtimeve kryesore për hartimin e strategjisë kombëtare për reformën në sistemin e drejtësisë të të miturve si dhe probleme të shumta që trajtohen në tryezat dhe konferencat që KSHH organizon, etj.

Letra e hapur drejtuar Kuvendit përmban propozimin e KSHH-së për ndryshimin e nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor ku bëhet fjalë për ngritjen e grupeve të numërimit të votave. Ky propozim është hartuar në bashkëpunim me OJF të tjera vendase dhe vjen pas një tryeze të rrumbullakët të organizuar nga KSHH lishur me Kodin Zgjedhor dhe ndryshimet që i janë bërë disa neneve të tij¹⁹.

KSHH nëpërmjet këtyre deklaratave u bën thirrje autoriteteve shtetërore përkatëse, dhe mbase shoqërisë që t'u kushtojnë vëmendje këtyre problemeve. Nxitje për këto reagime kanë qënë ankesat e shumta të mbërritura në adresë të KSHH-së, rastet e verifikuara nga KSHH dhe korrespondentët e tij në 7 rrethet e vëndit si dhe nga problematika që trajtohet nga media.

7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-së

7.1 Ankesat e qytetarëve

Gjatë muajve janar – mars 2005, në adresë të KSHH-së kanë ardhur gjithsej **38 ankesa dhe kërkesa**. Ankesat kanë ardhur kryesisht nëpërmjet letrave, takimeve në zyrat e KSHH-së si dhe nëpërmjet linjës telefonike²⁰.


Objekti i ankesave është kryesisht për procese të parregullta gjyqësore, shkelje të procedurave, vendime të padrejta gjyqësore, nga emigrantë që ndodhen në Greqi, keqtrajtim në burgje dhe vëndet e paraburgimit, për kushte jo të mira në burgjet ku ata vuajnë dënimin, për marrëdhënie të punës, kërkesa për këshillime ligjore dhe avokat falas, nga persona të ekstraduar nga Greqia,

¹⁸ Deklaratat dhe njoftimet per shtyp mund ti shihni më të plota në aneksin Nr.1 te këtij buletini gjithashtu dhe në faqen tonë të internetit eëë.ahc.org.al

¹⁹ Shih në pjesën e tryezave të rrumbullakëta, tryeza për zgjedhjet, 2 Mars 2005

²⁰ Linja telefonike është mundësuar nga projekti “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

transferim të personave me vendim të formës së prerë, çështje pronësie, etj.. Ankesat kundër organeve të gjyqësorit vazhdojnë të jenë me të njëjtin intensitet si në periudhat e mëparshme.



Në disa raste të denoncimit të keqtrajtimit të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit, KSHH ka reaguar menjëherë duke dërguar përfaqësues për verifikimin e tyre. Komiteti Shqiptar i Helsinkit kur e ka çmuar të nevojshme ka sugjeruar edhe ndërhyrë për rivendosjen e të drejtave duke u treguar i gatshëm që në rastet e duhura të ndërhyjë, verifikojë për marrjen e masave për shkeljet që ka konstatuar. Në këtë kuadër vlen të përmendet një bashkëpunim shumë të mirë, me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Rendit Publik, Drejtorinë e Përgjithshme të burgjeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së shtetit pranë Ministrisë së Rendit Publik dhe organe të tjera të pushtetit gjyqësor.

7.2 Raste të verifikuara nga KSHH

⇒ Në datën **11 Janar 2005**, pas një sinjalizimi që KSHH pati nga media për futjen në grevë urie të 35 të paraburgosurve në Komisaratin e Malësisë së Madhe, përfaqësues të KSHH-së realizuan disa kontakte për verifikimin e këtij rasti. KSHH kontaktoi me Shefin e dhomave të paraburgimit në Malësinë e Madhe, me Prokurorin e Rrethit Shkodër, si edhe me dy zv/Drejtorët e Policisë së Qarkut Shkodër. Nga verifikimet që u kryen rezultoi se arsyeja e futjes në grevë të të paraburgosurve ishte kryesisht për kushtet jo të mira në vendin e paraburgimit, si dhe mostransferimi i 8 të dënuarve me vendim të formës së prerë që qëndronin në këtë komisarjat. Aktualisht të dënuarit me vendim të formës së prerë janë transferuar në institucione të vuajtjes së dënimit.

⇒ Në datën **8 Janar 2005**, Komiteti Shqiptar i Helsinkit pas sinjalizimit të parë nga lëvizja "Mjaft" dërgoi dy vëzhgues të KSHH-së për të verifikuar rastin e vdekjes të romit 20 vjeçar Dritan Hashimit. Nga vëzhgimet e realizuara nga vëzhguesit e KSHH-së në zonën ku banon komuniteti Rom, Bregu i Lanës rezultoi se banorët e kësaj lagje ngrinin pretendime se D.Hashimi ishte helmuar me raki nga pronarët e tokës ku këta kanë ndërtuar baraket e tyre. Vëzhguesit e

KSHH-së verifikuan se trupi i pajetë i D.Hashimit ndodhej në urgjencën e orgnaeve të brëndshme në spitalin ushtarak ku pritej të bëhej dhe autopsia.

⇒ Në datën **22 shkurt 2005**, korrespondenti i Fierit ka marrë takim me familjarët e të miturit E.G, 14 vjeç i cili pretendonte se është keqtrajtuar nga policia e pikës kufitare të Kakavijës. Babai i tij ankohet se në pikën doganore të Kakavijës ndaj djalit të tij është ushtruar dhunë nga persona civilë të cilët më pas e kanë shoqëruar për në komisariatit e Gjirokastrës. Sipas babait të djalit, Z.G. policia shqiptare kufitare ka ushtruar dhunë ndaj djalit të tij duke patur inate të vjetra me vetë babin pasi para një viti kishte ndodhur një situatë e njëjtë me të. Korrespondenti kishte marrë takim dhe me vetë të miturin ku sipas tij i miturit kishte një skuqje të lehtë në faqe dhe nuk kishte shënja dhune ose plagë.

⇒ Në datën **21 Mars 2005**, rreth orës 19:00 KSHH kreu një vëzhgim në burgun e sigurisë së lartë, No. 302 në Tiranë. Shkak i këtij vëzhgimi u bë një letër anonime nga një grup të dënuarish e dërguar në redaksinë e disa mediave, të cilët ankoheshin për trajtime ç'njerëzore dhe ushtrim dhune në ambjentet e këtij burgu. Gjatë këtij vëzhgimi u morën takime me Drejtorin e burgut dhe me të dënuarit që gjendeshin në këto ambjente. Nga takimet rezultoi se drejtëpërdrejtë nuk u fol për dhunë por shpeshherë shprehjet e tyre linin hije dyshimi në vërtetësi, si dhe shumë prej tyre mendonin se letra e të burgosurve ishte e ekzagjeruar. KSHH i tërhoqi vëmendjen Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të ushtruar më shpesh monitorime në këtë institucion.

8. Komunikimi me autoritetet shtetërore dhe OJF-të vendase dhe të huaja

Gjatë periudhës Janar-Mars 2005, përfaqësues të KSHH-së kanë patur komunikime me autoritete shtetërore, organizata vendase dhe ndërkombëtare si Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme, etj.

Gjithashtu KSHH ka patur komunikime dhe me OJF-të vendase dhe ato të huaja, si Komitetet e Helsinkit në botë, Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit, Ambasadën Amerikane, Amnesty International, Organizatë ndërkombëtare OSBE, UNICEF, me Fondacionin SOROS si dhe me OJF-të vendase si me Qendrën shqiptare për të drejtën e njeriut, Kryqin e Kuq Shqiptar, Co-plan, etj..

KSHH i ka adresuar shqetësimet e tij autoriteteve shtetërore në 18 raste, objekt i të cilave kanë qënë ankesat e qytetarëve për shkelje të të drejtave të tyre, propozimi për ndryshime ligjore, informacione verifikimi që KSHH ka kryer në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut.

Autoritetet gjithashtu nuk kanë heshtur lidhur me shkresat që KSHH u ka dërguar dhe janë përgjigjur në rreth 14 raste, objekt i të cilave kanë qënë kthim përgjigje të letrave të KSHH mbi ankesat e qytetarëve, përgjigje për propozimet për ndryshime ligjore.

9. KSHH në media

KSHH gjatë kësaj periudhe ka informuar publikun nëpërmjet medias, duke dhënë intervista, opinione, emisione, shkrime dhe suplemente për probleme të ndryshme lidhur me liritë dhe të drejtat e qytetarëve.

9.1 Emisione në TV

KSHH gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në disa emisione në TV kombëtare, lidhur me çështje të ndryshme shqetësuese për mbarë publikun.

Gjatë kësaj periudhe, përfaqësues të KSHH-së ka marrë pjesë dy herë si e ftuar në emisionin “50 Minuta”, tek TVA me gazetarin Rezear Xhaxhiu. Në këto emisione janë diskutuar reforma zgjedhore dhe përmirësimi i legjislacionit zgjedhor si dhe respektimi i të drejtave të paraburgosurve dhe të dënuarve në vendet e paraburgimit dhe burgje si dhe probleme të tjera si faktorët që vështirësojnë kalimin e vendeve të paraburgimit nga varësia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë, transferimi i të dënuarve me vendim të formës së prerë, mbipopullimi, trajtimi i grupeve vulnerabel, mungesa e infrastrukturës në institucionet penitenciare, etj.,

Në këtë mënyrë publiku u njoh më konkretisht me këto probleme.

9.2 Pasqyrimi i aktiviteteve të KSHH-së në media

Gjatë muajve janar – mars 2005, KSHH është fokusuar më shumë në ato çështje të cilat janë shqetësuese dhe që ia ka bërë të njohura nëpërmjet intervistave, shkrimeve, opinioneve, suplementave në media. Gjithsej janë dhënë **5 intervista** dhe shkrime në median e shkruar si dhe gjatë muajit janar **një suplement** lidhur me pozicionin e pakicave në RSH. Intervistat dhe shkrimet kanë trajtuar kryesisht probleme të reformës zgjedhore dhe proceseve parazgjedhore, ushtrimi i dhunës ndaj emigrantëve, kushtet në burgje dhe vendet e paraburgimit, etj.,

Deklaratat e KSHH-së janë pasqyruar ashtu dhe shumë aktivitete të KSHH-së, konferenca, tryeza sensibilizuese, vëzhgime, etj. janë pasqyruar shpesh herë në median e shkruar dhe atë elektronike²¹.

10. Ngritje kapacitetesh

10.1 Trajnime dhe ngritje kapacitetesh për stafin e KSHH-së

a) Trajnim për korrespondentët e KSHH-së në rrethe në fushën e zgjedhjeve dhe të burgjeve²²

Në datën 25 Mars 2005, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një trajnim gjysëm ditor për korrespondentët e KSHH-së në rrethe lidhur me dy tema kryesore; fushat e vëzhgimeve dhe metodologjia që duhet ndjekur për procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor dhe tematika e dytë ishte trajtimi i problemeve të hasura gjatë vëzhgimeve të korrespondentëve të KSHH-së në vendet e paraburgimit në rrethe.

Në këtë trajnim morën pjesë të gjithë korrespondentët e KSHH-së në 7 rrethet kryesore të vendit përkatësisht në Elbasan, Korçë, Gjirokastrë, Kukës, Fier, Shkodër dhe Vlorë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e korrespondentëve të KSHH-së lidhur me bazën ligjore (Kodin Zgjedhor të azhornuar) dhe metodikën që do t'i udhëheqë ata në monitorimin e të gjitha fazave kryesore të procesit zgjedhor, vëzhgimit e respektimit të afateve ligjore që kanë të bëjnë me listat e zgjedhësve, fushatën zgjedhore, procesin e votimit dhe të numërimit të votave²³, si dhe trajnimi u përqëndrua në fushat kryesore që janë gjetur problematike lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave të paraburgosur.

b) Trajnim i vëzhguesve të KSHH-së për vëzhgimin e procesit parazgjedhor

²¹ Deklaratat janë pasqyruar në median e shkruar dhe elektronike rreth 23 herë,

²² Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” dhe “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut nëpërmjet monitorimit, studimit, lobimit dhe mbrojtjes për një respektim më të mirë të parimeve Kushtetuese” mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

²³ Për këtë qëllim u përgatit dhe një guidë me pyetje-përgjigje lidhur me problemet e procesit parazgjedhor dhe atij zgjedhor

Në datën 30 Mars 2005, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një trajnim gjysëm ditor me disa vëzhgues të KSHH-së për rrethin e Tiranës me temë "Vëzhgimi i shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve". Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e vëzhguesve të KSHH-së lidhur me bazën ligjore për vëzhgimin e procesit të shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve si dhe në respektimin e afateve ligjore për shpalljen dhe korrigjimin e tyre. Në këtë trajnim vëmendja u përqëndrua në disa aspekte kryesore të procesit të shpalljes së listave paraprake të zgjedhësve të tilla si shpallja e listave të zgjedhësve në vende publike të dukshme nga të gjithë zgjedhësit brenda afateve të përcaktuara ligjore përkatësisht, faktorët kryesorë që vështirësojnë dhe pengojnë këtë proces sipas përfaqësuesve të njësive vendore si edhe identifikimi i mundësive për përmirësimin dhe shpejtimin e këtij procesi.

c) Seminar trajnues për të drejtat dhe advokacinë

Në datat 25-27 shkurt në Ohër, Maqedoni u organizua një trajnim me temë "Advocacy and rights training seminar". Në këtë trajnim u trajtuan çështje të ndryshme si: minoritetet, te drejtat e tyre, çfarë parashikon ligji ndërkombëtar mbi minoritetet, mekanizmat e mbrojtjes, etj. Në këtë seminar merrnin pjesë përfaqësues të organizatave pjesëmarrëse në BHRN. KSHH u përfaqësua në këtë trajnim nga znj. Klesta Alikaj, juriste/Asistente Administrative dhe nga znj. Zana Sota, anëtare e KSHH-së.

d) Ngritje kapacitetesh të stafit nëpërmjet seminari trajnues "Ngritje fondesh të një organizate", mbështetur financiarisht nga SOROS

Në datat 2 - 5 mars 2005, KSHH i përfaqësuar nga znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh mori pjesë në seminarin trajnues "Ngritje fondesh" (Fundraising), mbështetur nga Soros. Qëllimi i tij ishte trajnimi i punonjësve të organizatave në fushën e ngritjes së fondeve për organizatën e tyre. Në këtë seminar u trajtuan disa çështje si parime të mënyrës së ngritjes së fondeve, parime të mobilizimit të burimeve, burimet e fondeve, modele për shkrime të suksesshme projektsh, situata me donatorët në Shqipëri, mënyra se si mund të hartohet një strategji që organizata të ketë një stabilitet nga pikëpamja e mbështetjes financiare, mënyrat se si mund t'i ofrohesh sektorit privat dhe individëve, mënyrat e paraqitjes së një projekt-propozimi si edhe të një analize për stakeholders si dhe u zhvilluan kazuse praktike për të gjitha çështjet e trajtuara.

10.2 Pjesëmarrje e KSHH-së në aktivitete të ndryshme

KSHH ka marrë pjesë në një sërë aktivitete të zhvilluara nga organizata vendase dhe të huaja si dhe nga institucionet shtetërore. Objektet e aktiviteteve ku KSHH ka marrë pjesë janë të shumta, ndër to aktivitete në kuadër të përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare 2005 për koordinimin e veprimtarive vëzhguese, lidhur me legjislacionin për të miturit, probleme të rinisë romë, masat kundër dhunës në familje, respektimin e të drejtës së informimit të qytetarëve në administratën publike, etj..

Përgatiti për Internet: **Etilda SALIU**
Juriste/As.projektesh

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1, Ap.4, Tiranë, Kutia postare
Nr. 1752

Tel: 04 233671 & 04 229002

Fax: 04 233 671

E-mail: office@ahc.org.al; web site: www.ahc.org.al

ANEKS NR. 1 – DEKLARATA

1. Njoftim për shtyp “Drejtësia për të miturit” – 18 Janar 2005

Në kuadër të reformës ligjore për përmirësimin e sistemit të drejtësisë së të miturve, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit, më datën 18 Janar 2005, organizoi tryezën e rrumbullakët **“Drejtësia e të miturve – e tashmja dhe perspektiva”**.

Tryeza kishte si qëllim prezantimin e drejtimeve kryesore për hartimin e strategjisë kombëtare për reformën në sistemin e drejtësisë të të miturve; paraqitjen e paketës ligjore për ndryshimet në legjislacionin shqiptar lidhur me të miturit, për gatitur nga një grup ekspertësh të Ministrisë së Drejtësisë, mbështetur nga UNICEF-i; diskutimin e kësaj paketë duke sjellë mendime dhe komente nga organizata vendase dhe të huaja të të drejtave të njeriut dhe që kontribuojnë në praktikë për zbatimin dhe monitorimin e këtyre ligjeve.

Në sesionin e parë të saj, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë paraqiten disa nga drejtimet kryesore që do të mbulojë strategjia për sistemin e drejtësisë së të miturve, ndërsa në sesionin e dytë u prezantua paketa ligjore e ndryshimeve si dhe komente mbi disa nga propozimet e përfshira në këtë paketë.

Komiteti Shqiptar të Helsinkit, kontribuoi me dhënien e mendimeve lidhur me këtë paketë. Objekt diskutimi nga përfaqësues të KSHH-së u bënë disa probleme të rëndësishme të paketës si: moshja e fillimit të përgjegjësisë penale për të miturit, masat mjekësore dhe edukuese ndaj të miturve dhe zbatimi i tyre në praktikë, zbatimi i dënimit me gjobë, nevoja e ngritjes së seksioneve të të miturve pranë disa gjykatave të rretheve gjyqësore dhe specializimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

KSHH-ja është e mendimit se propozimi për rritjen e moshës së fillimit të përgjegjësisë penale nga 14 vjeç në 16 vjeç kërkon një studim paraprak të kriminalitetit nën moshën 16 vjeç, vlerësimin e rrezikshmërisë së veprave penale të kryera nga të miturit, ngritjen e qëndrave të kujdesit social dhe qëndrave të trajtimit të fëmijëve dhe të miturve të përjashtuar nga dënimi si dhe detyrimin e gjykatës që të vendosë në këto qëndra të miturit që ndonëse nuk kanë përgjegjësi penale kryejnë vepra penale me rrezikshmëri shoqërore.

Lidhur me zbatimin e dënimit me gjobë ndaj të miturve, KSHH-ja mendon se propozimi është i drejtë, por zbatimi i kësaj mase do të hasë në vështirësi nëse në ndryshimet e propozuara nuk parashikohet personi që do të paguajë gjobën për fëmijët që nuk janë në marrëdhënie pune. Nga ana tjetër, KSHH mendon se vjelja e gjobës mund të paraqesë vështirësi pasi shumica e fëmijëve që kryejnë krime vijnë nga familje të varfëra. Për këtë KSHH është e mendimit se nëse familjet kanë të ardhura, pagesa e gjobës të bëhet nga prindi, kujdestari ose personi që e ka në ngarkim fëmijën dhe për fëmijët që vijnë nga familje që nuk kanë mundësi të paguajnë gjobën të zbatohet masat të tjera edukative.

Lidhur me masat edukative që propozohen të shtohen në Kodin Penal, KSHH është e mendimit se miratimi i tyre është i domosdoshëm. Zbatimi i tyre do të ndikojë në përmirësimin e politikës së riintegritimit të të miturve që kryejnë krime. Por krahas miratimit të këtyre masave duhet paralelisht të punohet për ngritjen e institucioneve të edukimit dhe të riedukimit, për përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar në fushën e të miturve, si dhe për trajnimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve që do të japin drejtësinë për të miturit.

KSHH është e mendimit se krahas miratimit të ndryshimeve të propozuara paralelisht duhet të për gatiten edhe aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me funksionimin e shërbimeve që do të mbikqyrin zbatimin e masave edukative si dhe përcaktimi i rolit të psikologut në këtë proces.

Lidhur me përmirësimin e legjislacionit shqiptar për trajtimin e të dënuarve të mitur në vëndet e paraburgimit dhe në burgje, KSHH-ja vlerëson përmirësimet e propozuara por është i mendimit që dënimi me burgim duhet të jetë masa e fundit që duhet të zbatohet ndaj të miturit.

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, veprimtaria e të cilëve ka lidhje me të drejtat e të miturve, anëtarë të grupit të punës që për gatitën paketën ligjore, anëtarë të komisionit të reformës ligjore, përfaqësuesve të organizatave të huaja që veprojnë në Shqipëri, ekspertë të fushës së të miturve, përfaqësues të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në përgjithësi dhe atë të të miturve në veçanti.

2. Njoftim pwr shtyp - Mbi konferencën “Bashkëekzistenca e minoriteteve dhe respektimi i të drejtave të tyre”

Tiranë, Janar 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur (Soros), në datën 3 dhjetor 2004, organizoi konferencën me temë: **"Bashkëekzistenca e minoriteteve dhe respektimi i të drejtave të tyre"**.

Konferenca kishte për qëllim të nxirrte në pah bashkëekzistencën e minoriteteve dhe respektimin e të drejtave të tyre në rajon dhe më gjerë; rolin e shoqërisë civile në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe komuniteteve, në rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të minoriteteve për të drejtat dhe realizimin e tyre dhe nevojën e bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm në vend dhe në rajon me qëllim që të sigurohet bashkëjetesa dhe mirëkuptimi ndërmjet tyre.

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të minoriteteve dhe komuniteteve në vend, përfaqësues të autoriteteve shtetërore, aktorë të shoqërisë civile, akademikë dhe profesorë të Universiteteve në Shqipëri që njohin çështjen e minoriteteve në vend dhe rajon, përfaqësues të përfaqësive diplomatike dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri dhe Europë. Gjithashtu, përfaqësues të Komiteteve të Helsinkit të vendeve fqinjë sollën përvojën e tyre lidhur me situatën e respektimit të të drejtave të pakicave në vendet e tyre.

Punimet e konferencës u zhvilluan në tre sesione, në të cilat pati referime dhe diskutime nga të pranishmit për temat e paraqitura.

Në panelin e parë u diskutua përkufizimi i nocionit "minoritet", dhe vështirësitë e përcaktimit të këtij koncepti. Çështja e minoriteteve u trajtua që prej periudhës së luftës së parë Botërore, kohë kur kjo çështje tërhoqi vëmendjen dhe u shtrua në shkallë ndërkombëtare. Folësit e këtij paneli trajtuan gjerë problemin e minoriteteve në Europë duke e parë atë nga pikëpamja ligjore, shtrirjen demografike të minoriteteve në Shqipëri dhe bënë një paraqitje të përgjithshme të ndarjeve dhe nëndarjeve të minoriteteve në vendin tonë.

Objekt trajtimi dhe më pas diskutimi ishte legjislacioni shqiptar në mbrojtje të të drejtave të minoriteteve si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni tjetër; angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në drejtim të mbrojtjes së pakicave kombëtare dhe detyrimet në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Gjithashtu, Konventa Europiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe raste të praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ishin objekt trajtimi nga ekspertët pjesëmarrës në këtë tryezë.

Në panelin e dytë u trajtua problematika e minoriteteve në Ballkan e parë në këndvështrimin historik, zhvillimet më kryesore dhe mësimet që mund të nxjerrë rajoni i Ballkanit për të ndërtuar një model bashkëekzistence në rajon. Ndërmjet të tjerave, u trajtuan çështje të tilla si: demokratizimi dhe begatimi i hapësirës ballkanike, integrimi i vendeve të rajonit në familjen e vendeve demokratike të bashkësisë euroatlantike të cilat janë të lidhura ngushtë me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave etnike. Në këtë vështrim, pakicat etnike duhen vlerësuar si ura lidhëse, faktorë miqësie e bashkëpunimi midis kombeve të gadishullit dhe jo si instrumente presioni për interesa të caktuara politike. Një koncept i tillë bashkëkohor duhet të jetë në vëmendje edhe të nismave integruese në kuadër rajonal, të cilat gjithashtu formojnë një prirje të natyrshme të zhvillimeve aktuale dhe një perspektivë për hapësirën ballkanike. Gjatë këtij paneli u diskutua ideja se bashkëjetesa paqësore e grupeve të ndryshme etnike, fetare ose gjuhësore nuk është relike e ndonjë bote të perënduar ose projekt i së ardhmes europiane, por një realitet në kushtet kur vendet e Ballkanit kanë hyrë në rrjedhat e zhvillimeve demokratike dhe kur ka një prani të gjerë ndërkombëtare në rajon.

Përfaqësuesit e Komiteteve të Helsinkit nga rajoni sollën përvojën e tyre në lidhje me respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në vendet si Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoni. Megjithë zhvillimet pozitive në drejtim të përmirësimeve të kuadrit ligjor lidhur me të drejtat e pakicave, përsëri ka shumë për të bërë në rritjen e pjesëmarrjes së pakicave në jetën politike, ekonomike të këtyre vendeve, në proceset e vendmarrjes dhe bërjen e politikave si edhe rritja e pjesëmarrjes së pakicave në administratën publike.

Paneli i tretë trajtoi rolin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe kontributin e saj të pazëvendësueshëm në drejtim të respektimit më të mirë të të drejtave të minoriteteve. Në të u prezantuan veprimtaritë e larmishme dhe të vazhdueshme të KSHH-së, fondacionit SOROS, të Institutit të medias dhe disa aktorëve të tjerë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare.

Përfaqësuesja e KSHH-së paraqiti veprimtaritë e KSHH-së në drejtim të mbrojtjes dhe sensibilizimit të pakicave në Shqipëri si : vëzhgimet në terren të respektimit të të drejtave të minoriteteve në zonat ku jetojnë minoritetet dhe komunitetet; përgatitja e raporteve që përmbajnë përfundime dhe rekomandime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve dhe komuniteteve; adresimi i problemeve te organet përgjegjëse shtetërore me qëllim përmirësimin e respektimit të të drejtave të pakicave në vend; veprimtaritë sensibilizuese në lidhje me të drejtat e pakicave dhe mekanizmat e mbrojtjes së këtyre të drejtave; organizimi i forumeve për të ndërgjegjësuar organet shtetërore në nivel qendror dhe vendor për problemet që shqetësojnë pakicat në vend si edhe mbi rrugët e zgjidhjes së një pjese të këtyre problemeve; publikimet e ndryshme informuese në gjuhët e pakicave, fletëpalosjet, posterat dhe emisionet në median kombëtare dhe vendore.

Fondacioni për Shoqërinë e Hapur për Shqipërinë (SOROS) është një tjetër aktor i rëndësishëm i shoqërisë civile që ka dhënë kontributin e tija për disa vjet me radhë në zbatimin e programit “Përmirësimi i marrëdhënieve ndër-etnike në Evropën Juglindore”, program ky i përkrahur nga pesë vende të rajonit. Ky program kishte për qëllim dhënien e granteve dhe rritjen e kapaciteteve të grupeve pjesëmarrëse të mbështetura edhe nga një numër i konsiderueshëm OJF-sh vendase. Objektivat e këtij programi kanë qenë rritja e përfaqësimit të minoriteteve dhe komuniteteve në administratën vendore dhe qendrore; promovimi i mirëkuptimit dhe tolerancës; si edhe promovimi i integritit të këtyre grupeve minoritare dhe etnive të ndryshme në jetën e vendit.

Instituti i Medias Shqiptare, një tjetër OJF vendase, ka punuar për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të medias elektronike dhe asaj të shkruar mbi çështjen e të drejtave të minoriteteve. Ndërsa CRCA i njohu pjesëmarrësit me aktivitetet e kësaj organizate në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që i përkasin minoriteteve dhe komuniteteve. Këto aktivitete janë shtrirë si në përmirësimin e legjislacionit për të miturit dhe politika të cilat favorizojnë këta të fundit deri në shërbime konkrete të ofruara ndaj fëmijëve romë. Gjithashtu, në këtë kuadër vlen të përmendet edhe ndihma e dhënë nga CAFOD (TLAS), një OJF aktive në ofrimin e shërbimit ligjor falas për qytetarët e thjeshtë. Kjo organizatë po punon në drejtim të rregjistrimit të lindjeve të minoritetit rom si edhe në identifikimin e shtetasve me kombësi të ndryshme.

Përfaqësuesit e minoriteteve dhe komuniteteve në Shqipëri, pjesëmarrëse në këtë konferencë bënë prezent shqetësimet e tyre në lidhje me një respektim më të mirë të të drejtave të pakicave në vend. Një pjesë e mirë e këtyre çështjeve të ngritura nga këto organizata përfaqësuese të pakicave janë bërë pjesë e përfundimeve dhe rekomandimeve të paraqitura më poshtë.

1. Shqipëria renditet ndër vendet që njeh dhe promovon të drejtat e minoriteteve dhe komuniteteve që jetojnë në vend. Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë i cili është përmirësuar me qëllim për t’u përputhur me Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Madje vlen për t’u theksuar se fryma kushtetuese dhe ligjore në Shqipëri është shumë më progresive se fryma e disa vendeve të tjera anëtare të BE-së si p.sh. Greqia, Franca etj. Megjithatë, në drejtim të përmirësimeve të mëtejshme të kuadrit ligjor lidhur me të drejtat e pakicave, rëndësi ka pjesëmarrja e përfaqësuesve të minoriteteve dhe komuniteteve në Shqipëri.

2. Mungesa e një përkufizimi të plotë dhe të qartë të nocionit “minoritet” ka sjellë shumë vështirësi lidhur me përcaktimin e saktë të atyre që duhet të trajtohen minoritete në Shqipëri dhe kjo u ka lënë hapësirë interpretimeve të ndryshme.

3. Rregjistrimi i plotë dhe i saktë i popullsisë minoritare që jeton në Shqipëri mbetet një ndër problemet e ngritura edhe në këtë konferencë. Nga pjesëmarrësit u theksua se të dhënat zyrtare statistikore të sakta do të shërbejnë më pas për përcaktimin e politikave dhe përbushjen e detyrimeve nga ana e shtetit shqiptar për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve dhe komuniteteve në vend.

4. Lidhur me të drejtën e arsimimit të pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare kjo bëhet në bazë të numrit të individëve që u përkasin pakicave, kompaktësisë së tyre, si dhe me mundësitë ekonomike që ka shteti shqiptar për të përballuar hapjen e shkollave në gjuhën e pakicave. Edhe njëherë del në pah domosdoshmëria e rregjistrimit të saktë të pakicave kombëtare në vendin tonë. Megjithatë, për t’i ardhur në

ndihmë këtyre minoriteteve mund të krijohen klasa të veçanta për arsimimin e tyre ose krijimi i shkollave mbi bazën e iniciativave private.

5. Nga të gjithë të pranishmit u pranua rekomandimi i KSHH-së se duhet më shumë vëmendje nga ana e strukturave shtetërore ndaj minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian si edhe duhet këmbëngulur në luftën kundër paragjyqimeve diskriminuese dhe raciale ndaj individëve që u përkasin këtyre komuniteteve. Për përmirësimin e situatës së të drejtave dhe lirive të tyre si dhe në përgjithësi për integrimin e tyre në shoqëri dhe në jetën e vendit është e domosdoshme të hapen shkolla në gjuhën shqipe në zonat e banuara prej romëve dhe egjiptianëve.

6. Radiotelevizioni Publik Shqiptar duhet t'u sigurojë minoriteteve një akses më të madh në median publike nëpërmjet lajmeve, programeve kulturore, informative dhe edukative në gjuhën e minoriteteve si dhe me qëllim promovimin e kulturës dhe traditave të tyre kombëtare. Madje nga përfaqësues të minoriteteve dhe komuniteteve u kërkua që në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit duhet të ketë përfaqësues të tyre.

7. Përfaqësues të komuniteteve kërkojnë projekte për emancipim dhe zhvillimin e tyre si dhe rritje të aksesit të tyre në organet e pushtetit vendor dhe qendror. Përfaqësimi në nivel vendor dhe qendror i disa minoriteteve apo komuniteteve të caktuara si p.sh. romët dhe egjiptianët janë në nivele jo të mjaftueshme.

8. Bashkëpunimi i organet shtetërore me organizatat që përfaqësojnë minoritet dhe komunitet në Shqipëri duhet të jetë jo vetëm në fazën e hartimit të strategjive përkatëse, por edhe të zbatimit të tyre.

9. Pjesa më e madhe e organizatave që përfaqësojnë pakicat kombëtare dhe komunitetet kanë në përgjithësi kapacitete të dobta. Për rrjedhojë, zëri i tyre nuk ndihet sa duhet. Në këtë drejtim, mendojmë se duhet punuar më shumë në këtë drejtim, në mënyrë që ato të kthehen në grupe presioni të vazhdueshme ndaj organeve shtetërore përgjegjëse për garantimin e të drejtave të pakicave.

10. Shoqëria civile ka kontribuar dhe duhet të vazhdojë të japë ndihmesën e saj për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri.

3. DEKLARATË E PËRBASHKËT - KOMITETI SHQIPTAR I HESLINKIT DHE SHOQATA PËR KULTURË DEMOKRATIKE

26 Janar 2005

Të mos kufizohen të drejtat e vëzhguesve

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe Shoqata "Për kulturë Demokratike" (SHKD) pasi u njohën me ndryshimet që iu bënë Kodit Zgjedhor me ligjin nr. 9341, datë 10.I.2005 i përshëndetën ato. **Këto ndryshime janë një hap përpara drejt përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit tonë zgjedhor që synon të garantojë zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakontestuar.**

Nga studimi paraprak i këtyre ndryshimeve mendojmë se në këtë Kod **ka ende disa formulime jo të plota dhe jo të sakta**, madje edhe ndonjë **dispozitë që bie ndesh me Kushtetutën**. Shpresojmë që në të ardhmen ato të rishikohen.

Por pavarësisht nga kjo, **KSHH dhe SHKD e shikojnë të nevojshme të bëjnë publik qëndrimin e tyre vetëm për një çështje që ka të bëjë me të drejtat e vëzhguesve në procesin zgjedhor.**

Me ligjin e mësipërm është ndryshuar neni 18 i Kodit zgjedhor që titullohet "E drejta për të caktuar vëzhgues". Në pikën 4 të nenit 18 të pandryshuar thuhej se kërkesa e vëzhguesve shqiptarë për akreditim i paraqitet KQZ-së jo më vonë se 15 ditë para datës së zgjedhjeve. Nga kjo del se kjo kërkesë mund t'i paraqitet KQZ-së të themi edhe para 3-4 muajve para datës së zgjedhjeve, ndërsa me ndryshimet që iu bë nenit të mësipërm kërkesa e vëzhguesve shqiptarë mund t'i paraqitet KQZ-së **jo më herët se 45 ditë** para datës së zgjedhjeve.

Ky ndryshim kufizon në mënyrë të dukshme monitorimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit shqiptarë. Atyre u jepet mundësia të vëzhgojnë vetëm fushatën zgjedhore, votimin dhe numërimin e votave.

KSHH dhe SHKD mendojnë se para se të bëhej ky ndryshim duhej parë edhe neni 19 i po këtij Kodi që nuk është ndryshuar ku vëzhguesve u jepej e drejta “të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e përgatitjes dhe zhvillimit të zgjedhjeve”. **Nga kjo del se neni 18 i ndryshuar lidhur me këtë çështje vjen në kundërshtim me nenin 19 gërma “a” të pandryshuar të të njëjtit Kod.**

KSHH dhe SHKD mendojnë gjithashtu se Kuvendi para se të miratonte këtë ndryshim duhet të kishte parasysh edhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të Prillit 2004 ku thuhet se **“organizatat e vëzhguesve duhet të përfshihen që në fazat e hershme të procesit me qëllim vëzhgim të të gjitha proceseve zgjedhore”** (shih rekomandimet, përkthim shqip, faqe 16).

KSHH dhe SHKD i sugjerojnë Kuvendit që të amendojë ndryshimi që i është bërë nenit 18 të Kodit Zgjedhor dhe të mos kufizohet e drejta e vëzhguesve. Kufizime të tilla nuk i shërbejnë monitorimit të gjithanshëm dhe cilësor të zgjedhjeve.

3. GJYQI I SOTEM MBI VRASJEN E VULLNET BYTYÇIT I PADREJTE

Tiranë, më 23 shkurt 2005

Sot, në Kastoria (Kostur) Greqi, në Gjykatën Tre-palëshë të Kundravajtjeve po zhvillohet gjyqi i rojes kufitare që vrau më 23 shtator 2003, 18-vjeçar in Vullnet Bytyçi.

18 vjeçari Bytyçi u qëllua pas koke e u vra nga punonjës të policisë greke afër pikës së kontrollit Kapshticës ndërkohë që po përpiqej t'i shpëtonte arrestimit. Katër shqiptarë të tjerë me të cilët ai po udhëtonte për në Greqi me qëllim punësimi, Alfred Ramadan Metaliaj, S. Metaliaj, Beqir Osman Metaliaj dhe Bilbil Selman Metaliaj, u arrestuan dhe u liruan më vonë dhe u kthyen në Shqipëri më 27 shtator 2003. Sipas njoftimeve, personi i gjashtë Luan Metaliaj i shpëtoi arrestimit dhe u fsheh për 24 orë para se të kthehej në Shqipëri. Sipas njoftimeve një plumb i përshkoi xhakët pa e plagosur gjatë arratisjes. Policia greke raportoi se një polic i rojës kufitare qëlloi në ajër që të parandalonte arratisjen e tij si dhe qëndrimin e tyre kërcënues ndaj njërit koleg të tij. **Patë njoftime se në kohën kur ai u qëllua, 18-vjeçari Bytyçi ndaloi vrapin e tij dhe nuk paraqiti ndonjë rrezikshmëri.**

Autoritetet greke njoftuan në atë kohë se polici i rojes kufitare përgjegjës për vrasjen do të gjykohej sipas ligjit grek. **Megjithëse ai u akuzua në fillim për krimin e vrasjes nga pakujdesia, Këshilli i Kundravajtjeve më vonë i ndryshoi akuzat nga krim, në kundravajtje. Akoma më keq, sot më 23/2/2005 asnjë nga dëshmitarët e familjes Metaliaj nuk u lejua të dëshmonte para gjykatës.**

Për të gjitha këto arsye, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe Vëzhguesi i Helsinkit Grek (VHG) e konsiderojnë këtë një gjyq të padrejtë, si shkelje të Nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ata i bëjnë thirrje autoriteteve greke ta shqyrtojnë procedurën dhe të sigurojnë zhvillimin e një gjyqi të paanshëm me praninë e të gjithë dëshmitarëve. Gjithashtu ata duhet t'u japin dëmshpërblim të mjaftueshëm familjes së viktimës.

Në mënyrë më të përgjithshme, KSHH dhe VHG kujtojnë se Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) **‘ka shprehur keqardhjen’ për mungesën e zhvillimit të një procesi të duhur në hetimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të shqiptarëve dhe shprehu besimin ‘se kjo nuk do të tolerohet më’.** Është koha e duhur që Greqia ta zbatojë këtë rekomandim.

KSHH dhe VHG u kërkojnë gjithashtu autoriteteve shqiptare të marrin përsipër mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve para gjykatave greke në të njëjtën mënyrë siç bëjnë qeveritë e tjera europiane për qytetarët e tyre në Greqi. Vetëm kështu shqiptarët do të kenë mundësi të një trajtimi të drejtë në Greqi siç kanë qytetarët e vendeve të tjera europiane të cilëve u jepet mbështetje nga autoritetet konsullore të vendeve të tyre.

4. Njoftim për shtyp – Paraqitja e të dhënave të dala nga vëzhgimet e KSHH-së lidhur me respektimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve”

Tiranë, më 9 Shkurt 2005

Në datën 9 Shkurt 2005, në ambjentet e Hotel Rogner, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi tryezën me temë “Paraqitja e të dhënave të dala nga vëzhgimet e KSHH-së lidhur me respektimin e të drejtave të të parburgosurve dhe të të dënuarve”. Ky aktivitet u krye në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri” i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit. Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i përfundimeve dhe rekomandimeve më kryesore të dala nga procesi i vëzhgimeve që KSHH-ja ndërmori në disa vende parburgimi dhe burgje lidhur me respektimin e të drejtave të të parburgosurve dhe të dënuarve nga administrata e këtyre institucioneve. Në këtë aktivitet morën pjesë Z. Anastas Duro, Zv. Ministër i Drejtësisë, përfaqësues të lartë nga Ministria e Drejtësisë, Z. Ëngjëll Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, përfaqësues të tjerë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfaqësues të lartë nga Ministria e Rendit Publik, përfaqësues nga institucione të tjera shtetërore të tilla si nga zyra e Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë, Prokuroria e Rrethit Tiranë, Avokati i Popullit, si edhe disa nga drejtuesit e institucioneve të vëzhguara. Pjesëmarësit në këtë tryezë vlerësuan përfundimet e KSHH-së si objektive dhe të paraqitura me një kulturë profesionale. Më poshtë po ju paraqesim disa nga çështjet e ngritura në tryezë:

Gjatë muajve shtator – dhjetor 2004, KSHH-ja ka ndërmarrë një raund misionesh vëzhgimi në 16 komisariate policie me dhoma parburgimi përkatësisht në rrethet Berat, Elbasan, Vlorë, Tepelenë, Korçë, Pogradec, Durrës, Krujë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Krujë dhe Mat si edhe institucionin e parburgimit nr. 313 Tiranë. Në institucionet e riedukimit KSHH ndërmori vëzhgime në Burgun nr. 325 dhe nr. 302 Tiranë, Burgun e Krujës, të Tepelenës, Peqinit, Rogozhinës, Vaqarrit, dhe Spitalin e Burgut. Vëzhgimet u realizuan nga një grup prej 34 vullnetarë të përzgjedhur nga KSHH në fusha të tilla si drejtësi, shkenca sociale dhe mjekësi, të cilët u trajnuan për objektin e vëzhgimit, metodologjinë e tij dhe përgatitjen e raportit të vëzhgimit.

A. Respektimi i të drejtave të personave në vendet e parburgimit

1. Kuadri ligjor dhe nënligjor. Legjislacioni në këtë fushë mendojmë se është bashkëkohor. Vëzhgimet e fundit të KSHH-së konfirmuan edhe një herë se në mjaft raste, defektet, mungesat ose shkeljet ligjore që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në cënimin e të drejtave të të parburgosurve dhe të dënuarve nuk kanë të bëjnë me boshllëqet në ligj. Megjithatë, duam të sjellim në vëmendje faktin se administrata e vendeve të parburgimit, me përjashtim të parburgimit të Vlorës dhe atij nr. 313, Tiranë, zbatonte Rregulloren Nr. 1075, datë 15.09.1999 të Ministrisë së Rendit “Për sigurimin e trajtimit e të parburgosurve”, në një kohë kur është miratuar nga Ministria e Drejtësisë, Rregullorja “Për organizimin e funksionimin e sistemit të parburgimit” nr.3750/2 datë 23.07.2003. Duke patur parasysh faktin se sistemi i parburgimit me ligj është nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, **KSHH tërheq vëmendjen e autoriteteve përkatëse se zbatimi ende i Rregullores Nr. 1075, datë 15.09.1999 të Ministrisë së Rendit “Për sigurimin e trajtimit e të parburgosurve” është jo vetëm i papranueshëm, por edhe i kundraligjshëm.**

2. Varësia e vendeve të parburgimit.

Sistemi i parburgimit vazhdon të jetë në varësi të Ministrisë së Rendit Publik me përjashtim të institucionit nr. 313 dhe parburgimit të Vlorës në një kohë kur sipas nenin 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.V.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, thuhet: “Ministria e Drejtësisë drejton sistemin e parburgimit...”.

KSHH është në dijeni të vështirësive financiare dhe infrastrukture që kanë penguar këtë proces të ecë përpara si edhe masat që parashikon Masterplani për sistemin e parburgimit megjithatë KSHH, **vë në pah se mbajtja ende e parburgimit në varësi të Ministrisë së Rendit Publik përbën shkelje të ligjit nr. 8678, datë 14.V.2001 dhe të VKM-së nr. 327, datë 15.V.2003 dhe kërkon nga organet kompetente të marrin masa të shpejta dhe konkrete për zbatimin rigoroz të tij.**

Transferimi i vendeve të parburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë nuk përbën thjesht një detyrim ligjor, por kjo masë do të shoqërohet me një angazhim më të madh të vetë të këtij institucioni për të përmirësuar kushtet e parburgimit që janë me të vërtetë shqetësuese dhe ku elementët pozitivë janë thuajse të padukshëm.

3. Transferimi i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. KSHH ka përhëndetur masat e marra nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës në institucionet përkatëse të riedukimit, të cilat u intensifikuan për periudhën korrik-dhjetor 2004. Në përgjithësi, kjo ka ulur nivelin e mbipopullimit në komisarate. Megjithatë, nga vëzhgimet gjatë tremujorit të fundit të vitit 2004, në disa nga komisaritet u vu re një numër i konsiderueshëm të dënuarish me vendim të formës së prerë të gjykatës të cilët mbaheshin në ambjentet e paraburgimit.

Duke pasur parasysh faktin se mbajtja e të dënuarve në paraburgim çënon rëndë të drejtat e kësaj kategorie shtetasish si edhe përbën shkelje të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale, **KSHH u rekomandon organeve përgjegjëse shtetërore të marrin të gjitha masat për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës në vendet përkatëse të vuajtjes së dënimit ose të konvertohet koha e qëndrimit në paraburgim e kësaj kategorie individësh në favor të tyre, siç e parashikon ligji. Gjithashtu, KSHH rekomandon që të ketë një koordinim më të mirë të punës mes Prokurorisë së rrethit dhe DPSH-së që transferimet të bëhen në përputhje me ligjin.**

4. Lidhur me infrastrukturën e vendeve të paraburgimit. Nga vëzhgimet rezultoi se infrastruktura e ndërtesave të disa komisarateve të policisë ishte problematike. Gjithashtu, gjendja e ambjenteve të paraburgimit në pjesën më të madhe të tyre nuk plotësonte parametrat e përcaktuara në ligj. Këtu mund të përmendim ambjentet e paristrukturuara me lagështirë, mungesa e sistemit të ngrohjes, të orendive elementare në dhoma, ndriçimi natyror i pamjaftueshëm, dritë artificiale me ndërprerje, fjetja realizohet në kushte aspak normale, disa dhoma paraburgimi përmbytshin etj. Kjo gjendje serioze ka pasoja të rënda shëndetësore dhe psikologjike të cilat lënë gjurmë në personalitetin e personave të paraburgosur dhe çënojnë rëndë të drejtën e tyre për një jetë në kushte normale jetese.

Për sa më sipër KSHH tërheq vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse shtetërore që të përshejtojnë përpjekjet e tyre me qëllim përmirësimin e kushteve fizike në dhomat e paraburgimit, gjë që do të çojë në një respektim më të mirë të të drejtave të paraburgosurve.

5. Kushtet higjieno-sanitare dhe higjiena veti. Kushtet higjieno-sanitare në dhomat e paraburgimit janë të rënda për rrjedhojë e disa faktorëve të tilla si ndërtimi i këtyre ambjenteve para shumë vjetësh dhe mungesa e financimit për mirëmbajtjen apo rikonstruktimin e tyre. Fondet për këtë qëllim ose janë shumë të vogla ose nuk ekzistojnë fare. Gjithashtu, faktorë të tillë si mbipopullimi, oraret e kufizuara për të paraburgosurit për të shkuar në tualet, mbajtja e ushqimeve të sjella nga familjarët në dhomat e paraburgimit në kushte aspak higjienike çojnë në përkeqësimin e kushteve higjieno-sanitare në këto ambjente. Përsa i takon kushteve vetjake të të paraburgosurve, ato linin shumë për të dëshiruar pasi mungonin kushtet optimale.

Duke pasur parasysh sa më lart, KSHH u tërheq vëmendjen organeve përgjegjëse shtetërore se duhet të merren masat e nevojshme për të siguruar kushte të përshtatshme higjieno-sanitare për t'u garantuar kështu të paraburgosurve mundësi për një higjienë personale të përshtatshme. Gjithashtu, të krijohen mjedise frigoriferike për të ruajtur ushqimin e të paraburgosurve dhe këta të fundit nuk duhet të mbajnë ushqime në dhomat e paraburgimit.

6. Mbipopullimi. Dukuria e mbipopullimit, vazhdon të jetë e pranishme në pothuaj të gjithë vendet e paraburgimit ku është zhvilluar vëzhgimi. Numri i personave të disa dhomave të paraburgimit ka qenë dyfishi i kapacitetit të lejuar. Kjo gjendje çënon rëndë të drejtat e këtyre individëve. **KSHH nxit organet përkatëse që të përshejtojnë me vënien në zbatim të masave të parashikuara në këtë drejtim të Masterplanit për sistemin e paraburgimit.**

7. Ushqimi dhe shërbimi shëndetësor. Për sa i takon ushqimit që u sigurohet të paraburgosurve Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë ka përcaktuar normën ushqimore ku çdo person në paraburgim duhet të marrë 2700 kkal. Nga vëzhgimet rezultoi se norma dhe cilësia e ushqimit ishin larg kësaj norme, prandaj ushqimin e servirur nga personeli i vendeve të paraburgimit të paraburgosurit nuk e hanin, duke e kompensuar me ushqimin e thatë që u sillnin familjarët. **Gjithashtu, për të paraburgosurit e sëmurë, duhet bërë trajtimi me dietë të veçantë, të miratuar nga specialisti i policisë me kërkesë të mjekut.**

Shërbimi shëndetësor për të paraburgosurit linte shumë për të dëshiruar. Nga vëzhgimet rezultoi se në pjesën më të madhe të dhomave të paraburgimit shërbimi shëndetësor nuk realizohej gjatë 24 orëve në ditë ashtu siç është parashikuar në dispozitat ligjore, por të paraburgosurit vizitohen vetëm me kërkesën e

tyre. Në strukturën e këtyre vendeve të paraburgimit kishte mjek me kohë të plotë, por nga vëzhgimi rezultoi se në disa vende paraburgimi ai mungonte. Në këto raste shërbimi shëndetësor realizohej nga ndihmësmjeku në rastet ku kishte një të tillë ose nga mjeku i urgjencës së spitalit të qytetit. Kishte edhe raste kur mjeku ishte i mbingarkuar pasi mbulonte qarkun ku ndodhej paraburgimi. Problem shqetësues mbeteshin mugesat të theksuara në medikamenteve mjekësore si edhe në bazën materiale të nevojshme. Kjo gjendje e tillë shqetësuese u justifikua nga mjekët e paraburgimeve me faktin se, shumë nga ilaçet që mjekët u përshkruanin të paraburgosurve, nuk gjendeshin në listën e atyre barnave të cilat ata (mjekët) furnizoheshin nga Depoja e Barnave të Ministrisë së Rendit Publik. **KSHH rekomandon që të merren masa efikase për t'u siguruar të paraburgosurve një shërbim mjekësor në përputhje me ligjin si edhe të sigurohet furnizim i mjaftueshëm me ilaçe në paraburgim. Gjithashtu, duhet të krijohen ambiente të përshtatshme për të ofruar shërbimet mjekësore nga mjeku apo ndihmësmjeku brenda ambjenteve të paraburgimit.**

8. Trajtimi i të sëmurëve mendorë. Në disa dhoma paraburgimi të vëzhguara, të sëmurët mendorë dhe të sëmurët kronikë, mbaheshin në të njëjtat ambiente me të paraburgosurit e tjerë. **KSHH rekomandon që të sëmurët me probleme mendore ose psikike, ose të sëmurët me sëmundje kronike të transferohen në institucione të posaçme, të përcaktuara me ligj.**

9. Dhuna në vendet e paraburgimit. Pavarësisht nga fakti se sa të rralla kanë qënë rastet e përdorimit të dhunës ndaj të paraburgosurve (pretendohet se dhunë më tepër është përdorur në momentin e ndalimit ose arrestimit) është e nevojshme që ndaj shfaqjeve të tilla të mbahen qëndrime të prera deri edhe në procedim penal. Në këtë drejtim, disa herë Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka reaguar publikisht.

10. Njohja nga personat e paraburgosur me të drejtat e tyre. Njohja e të paraburgosurve me të drejtat që i garanton ligji merr rëndësi të veçantë. **Lidhur me këtë, KSHH sugjeron që të paraburgosurit duhet të informohen për të drejtat e tyre si edhe për të drejtën e mbrojtjes ligjore, që nga çasti i ndalimit ose arrestimit. Gjithashtu, KSHH rekomandon që të bëhet një punë më e madhe e personelit në paraburgim për t'i njohur të paraburgosurit me të drejtat dhe detyrimet e tyre për sa kohë janë në këto institucione.**

11. Të miturit në vendet e paraburgimit. Në përgjithësi nuk kishte seksione të veçanta për të miturit në paraburgimet e vëzhguara. Ata mbaheshin në dhomat e paraburgimit në disa raste edhe me elementë që paraqisnin rrezikshmëri të madhe shoqërore. Kjo vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor edhe atë nënligjor shqiptar i cili siguron një trajtim të veçantë për këtë kategori të paraburgosurish. **KSHH u rekomandon këtyre institucioneve se nëse mungon infrastruktura të merren masa që këta të mitur të mos mbahen në të njëjtat dhoma me persona me rrezikshmëri të lartë duke bërë një riklasifikim të të paraburgosurve me qëllim që të krijohen hapësira për një trajtim të veçantë të të miturve.**

Lidhur me shërbimin mjekësor dhe atë stomatologjik kishte probleme dhe ankesa nga të miturit e intervistuar. Kishte pretendime se mjeku nuk i kishte takuar kur e kishin kërkuar. Kishte edhe raste kur i mituri ka kërkuar të dërgohet në qendrën ambulatorie për trajtim stomatologjik dhe kjo nuk i është siguruar nga personeli i paraburgimit.

Lidhur me trajtimin e të miturve në paraburgim dhe në burgje do të sugjeronim të merren parasysh jo vetëm çështjet që u parashtruan më sipër por edhe problemet që janë trajtuar në një tryezë të mëparshme të organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me KSHH dhe UNICEF në lidhje me përmirësimin e projekt-akteve lidhur me sistemin e drejtësisë për të miturit.

12. Gratë në paraburgim. Gratë në paraburgim janë gjithashtu një kategori individësh për të cilët ligji ofron një trajtim të veçantë. Ndërkohë sistemit i tyre në ambiente të veçanta nga të paraburgosurit meshkuj realizohej me shumë probleme në paraburgim. Gjithashtu, në paraburgimet e vëzhguara nuk kishte personel femra që të prisnin dhe sistemonin gratë për aq kohë sa ato mbaheshin në paraburgim.

Megjithatë, një shembull pozitiv vjen nga paraburgimi nr. 313 në Tiranë lidhur me trajtimin e veçantë që u sigurohet grave në paraburgim si në lidhje me punën edukative që bëhet me to dhe aktivitetet e tjera që organizohen gjatë programeve ditore.

13. Personeli në paraburgim. Nga intervistat me personelin në vendet e paraburgimit të vëzhguara, ata theksuan nevojën e trajnimeve të mëtejshme për t'u njohur me ndryshimet që pëson legjislacioni shqiptar penal si edhe trajnime në lidhje me zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në praktikë duke pasur parasysh realitetin e sistemit të paraburgimit në Shqipëri.

Megjithatë, që të zbatohet një legjislacion demokratik dhe bashkëkohor, veç të tjerave kërkohet që personat e ngarkuar me këtë detyrë të kenë koncepte të drejta, të jenë të bindur se puna e tyre duhet të kontribuojë që nesër personat e paraburgosur të integrohen në shoqëri. Kjo ka të bëjë me trajtimin human të tyre, taktin që duhet të tregojnë, me besimin që duhet të krijojnë tek ata, me punën edukative, kulturore dhe arsimore me krijimin e kushteve më të mira të jetesës, etj.

B. Respektimin i të drejtave të personave të dënuar me burgim

Këto dy vitet e fundit vërehen disa përmirësime në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit (burgjet). Gjatë kësaj periudhe, janë hapur burgjet e Peqinit dhe të Rrogozhinës. Së shpejti do të vihet në funksionim edhe burgu i Lezhës. Ministria e Drejtësisë, në këtë drejtim, ka një plan afatshkurtër dhe një plan afatgjatë si për infrastrukturën e burgjeve, ashtu dhe për kualifikimin e personelit që punon në to. Në kuadër të këtyre planeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është duke marrë masa konkrete për trajnimin e punonjësve të burgjeve në bazë të përvojës të disa vendeve demokratike. Gjithashtu, ka plane për hapjen e një fabrike për prodhimin e bukës për të burgosurit, si edhe të një oficine mekanike për automjetet etj. Po punohet gjithashtu, për përgatitjen e një plani edukimi të veçantë për të miturit etj.

Megjithatë, vëzhgimet e KSHH-së në disa burgje vërtetuan të meta dhe mungesa serioze, ndër të cilat mund të përmendim:

- a. Mosnjohja ose njohja e pakët e të dënuarve me të drejta që u siguron ligji;
- b. Kujdes i pamjaftueshëm për të miturit dhe për gratë;
- c. Mungesa të theksuara në kushtet higjieno-sanitare;
- d. Vizitat mjekësore nuk janë të rregullta, madje të sëmuret shpesh detyrohen të kërkojnë dhe të blejnë ilaçe që nuk sigurohen nga administrata e burgjeve;
- e. Vazhdon mbipopullimi gjë që sjell si pasojë keqësimin e kushteve dhe në disa raste edhe konflikte midis të dënuarve;
- f. Ka gjithashtu ankesa edhe për ushqimin sidomos për kalori të pamjaftueshme të tij;
- g. Ka ngadalësi në dërgimin e të sëmurve mendorë në institucionet e specializuara etj.

Të metat, mungesat dhe shkeljet e mësipërme të ligjit që çenojnë të drejtat e të burgosurve dhe që ndikojnë negativisht në trajtimin e tyre vazhdojnë të jenë shqetësuese. Disa janë të karakterit objektiv dhe disa të karakterit subjektiv. Të parat kanë të bëjnë me gjendjen relativisht të keqe të infrastrukturës, ndërsa të dytat me të metat në moszbatimin rigoroz të ligjit, si edhe me konceptet e padrejta që ekzistojnë në një pjesë të personelit të burgjeve për të dënuarit. Ky i fundit duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të përgatitet në kushtet e vuajtjes së dënimit për t'u integruar në shoqëri mbas lirimit të tij.

4. TË DREJTAT E SHQIPTARËVE NË GREQI

Shkurt 2005

A. Zhvillime pozitive

Pothuajse 15 vjet pasi emigrantët e parë shqiptarë arritën në Greqi, është e drejtë të pohohet që shteti grek, shoqëria greke dhe media greke, të gjithë janë dakort që emigrantët shqiptarë janë elementë të përhershëm dhe pozitivë në Greqi. Pavarësisht nga periudhat e vështira që shumica e emigrantëve përjetuan, tani ata mund të integrohen në shoqërinë greke. Qëndrimi i ligjshëm dhe sigurimet shoqërore janë në dispozicion, fëmijët shqiptarë ndjekin shkollën greke, dhe shumë prej tyre me rezultate të larta; shumë shqiptarë shquhen në profesione, arte, sporte. Sot, Greqia e njeh rolin jetësor të emigrantëve – dhe sidomos të shqiptarëve – në sukseset e paradokohshme madhore si hyrja në zonën “euro” dhe zhvillimi i lojrave olimpike.

B. Problemet kryesore

Pavarësisht nga zhvillimet pozitive, shqiptarët vazhdojnë të jenë objekt i diskriminimit shumëplanësh, sikurse thuhet në **Raportin e Tretë për Greqinë** (nxjerrë në Qershor 2004) nga Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI):

“Veçanërisht shqiptarët përballen me paragjykime dhe stereotipe edhe pse situata është përmirësuar disi” (paragrafi 100). “Disa media shprehin paragjykime dhe stereotipe të caktuara negative kundrejt (...)”

shqiptarëve (...). Deklarimet e përmendura hera herës toleroheshin nga autoritetet gjyqësore në emër të lirisë së shprehjes (...). Parimi i lirisë së shprehjes nuk shtrihet aq larg sa të autorizojë botimin e pohimeve raciste (paragrafi 96). “ECRI shpreh shqetësim mbi pretendimet serioze për keqtrajtimin e anëtarëve të grupeve të pakicave, të tilla si romët dhe emigrantët, të autorizuar ashtu edhe të paautorizuar. Keqtrajtimet e përmendura variojnë nga ofendimet raciste e deri tek dhuna fizike dhe ushtrohen ose gjatë ndalimit, ose në çastin e arrestimit. ECRI është veçanërisht i shqetësuar në lidhje ekzistencën e pretendimeve të shumëpërhapura për përdorimin e papranueshëm të armëve të zjarrit, ç’ka hera herës rezulton me vdekje” (paragrafi 105). “OJQ-të e të drejtave të njeriut tërheqin vëmendjen ndaj (...) rasteve ku supozohet që zyrtarë përgjegjës për akte dhune gëzojnë imunitet ndaj ndëshkimeve dhe procedimi i të cilëve ose nuk ka dhënë rezultate, ose as nuk është filluar. ECRI e gjen një situatë të tillë për të ardhur keq dhe shpreson që kjo nuk do të tolerohet më tej” (paragrafi 106). “ECRI është i shqetësuar mbi raportimet nga organizatat e të drejtave të njeriut se as fryma dhe as shkronja e ligjit (për emigracionin) (nr. 2910/2001) nuk zbatohen nga punonjësit civilë të ngarkuar me zbatimin e tij (...). ECRI, për rrjedhojë, gjykon që mbetet shumë për të bërë me qëllim që të stabilizohet një herë e mirë statusi ligjor i jo-nënshtetasve në Greqi” (paragrafi 116). “ECRI gjithashtu inkurajoi autoritetet greke që të parashikojnë mësim të gjuhës shqipe për nxënësit emigrantë shqiptarë” (paragrafi 43).

Pjesa më e madhe e këtyre problemeve nuk kanë për t’u pakësuar, dhe jo më të zhdruken, përderisa shqiptarët në Greqi – si dhe organizatat shqiptare – të fuqizohen për të qenë avokatë të efektshëm për të drejtat e tyre, përfshirë edhe mbrojtjen e vetes së tyre kur kanë probleme me ligjin, në mënyrë të justifikueshme ose të pajustificueshme. Një fuqizim i tillë bën të nevojshëm një bashkëpunim sistematik, të gjithanshëm dhe afatgjatë të autoriteteve shqiptare me organizatat shqiptare ose greke për të çuar zërin tek qindra mijëra emigrantë shqiptarë, për t’i informuar ata për të gjitha të drejtat e tyre dhe për t’i ndihmuar ose mbrojtur ata në mënyrë të tillë që të trajtohen pa diskriminim.

Rezidentët e ligjshëm shqiptarë duhet të mbeten gjithmonë të ligjshëm; shqiptarët e pafajshëm duhet të gjenden gjithmonë të pafajshëm; shqiptarët fajtorë duhet të gjenden gjithmonë fajtorë, por atyre t’u jepen dënime të ngjashme me ato që u jepen grekëve për krime të njëjta. Gjuha e urrejtjes kundër emigrantëve shqiptarë duhet ndëshkuar. Është e turpshme për Greqinë që gjykatat kanë shfajësuar median konvencionale që kanë botuar shkrime të tilla në të cilat imigrantët janë quajtur “llum i rrjedhur në Greqi dhe që ka ardhur për të vlarë, bastisur dhe përdhunuar Greqinë;” ose i referohet një “murtaje shqiptare,” me thirrje për “ashpërsi të pashoqe kundrejt atyre që shkelin ligjin me qëllim që shqiptarët të respektojnë grekët.”

Pa një përpjekje sistematike për fuqizim, disa përpjekje të vullnetarëve të OJF-ve mund të ndihmojnë vetëm për të zgjidhur probleme të vogla dhe të pakta. Pa një plan të gjithanshëm të autoriteteve shqiptare dhe OJQ-ve shqiptare dhe greke për të ngritur një rrjet avokatësh të ndershëm, kompetentë dhe të paguar siç duhet, shqiptarët në shumicën e rasteve kanë për të paguar avokatë që nuk do t’u japin mbrojtjen më të mirë të mundshme, ndërkohë që në më të shumtën e çështjeve, avokatët grekë kanë për t’u kërkuar pagesa më të larta. Përvoja e kohëve të fundit, sidomos rastet e vështira që kanë të bëjnë me keqtrajtimin, goditjen me armë ose zhdukjen e shqiptarëve dhe që janë në duart e autoriteteve greke, ka treguar që shpesh këto çështje duhet denoncuar pranë Këshillit të Europës ose OKB-së më mënyrë që autoritetet gjyqësore greke të fillojnë hetime ose t’i trajtojnë këto çështje në mënyrë të ndershme.

Raste të tilla, mund të duan vite të gjykoen dhe për rrjedhojë në rast se nuk monitorohen nga afër, mund të çojnë në pafajësi, duke injoruar ose zhdukur fakte kryesore.

Më 23 Shkurt 2005, gjyqi i rojes së kufirit grek që vrau 18 vjeçarët Vullnet Bytyçin në shtator 2003, do të zhvillohet pa praninë e dëshmitarëve të tjerë shqiptarë në gjykatë.

Hetimi i rastit të Gramoz Palushit të vlarë nga një racist pas ndeshjes së futbollit Shqipëri-Greqi në shtator 2004 duket se ka gjetur një vlerësim “komod” psikiatrik të autorit të krimit, ç’ka është shkencërisht i gabuar.

Punonjësi i policisë, i cili vrau Gentian Çelinikun në nëntor 2001 u lirua sepse gjykata pranoi një version alogjik, atë të goditjes aksidentale.

Deportimi i 10-vjeçarit Elvis Gjoni në tetor 2000, i cili u gjet i paligjshëm nga Avokati i Popullit i Greqisë, nuk u hetua kurrë nga policia; avokatëve të Elvisit u janë refuzuar dosjet dhe padia për kompensim nuk ka marrë një datë për seancë dëgjimore për afro tre vjet.

Në kundërshtim me rekomandimet e OKB-së, Greqia po refuzon t’u njohë romëve shqiptarë me qëndrim të ligjshëm mbrojtjen që u jep romëve grekë.

Rasti më i fundit më skandaloz është ai i 502 fëmijëve shqiptarë të rrugëve që u zhdukën midis 1998 – 2002, ndërkohë që ishin në duart e autoriteteve greke. Edhe pas një hetimi nga Avokati i Popullit i Greqisë, çështja

nuk iu dërgua prokurorit për të kryer hetim gjyqësor mbi zhdukjet. U desh një ankesë penale nga Monitoruesi Grek i Helsinkit në maj 2004 që prokurori të paraqiste padi penale “kundër cilitdo që përfshihej” për “rreëmbimin e fëmijëve më pak se 14 vjeç.” Padija u paraqit në dhjetor 2004, ndërsa në nëntor 2004, Komiteti Kundër Torturës i OKB-së shprehu shqetësimin e vet mbi çështjen, kërkoi një hetim gjyqësor dhe një raport nga Greqia për t’iu paraqitur Komitetit brenda një viti. Megjithatë, deri në fund të shkurtit 2005, lista e emrave të fëmijëve, pjesa më kyçe e provave, nuk është paraqitur nga policia për Avokatin e Popullit Grek dhe për t’iu përcjellë gjyqtarës së hetimit, e cila pa këtë provë nuk mund të fillojë punën e saj.

C. Përfundim

Zhvillimet pozitive që çuan në pranimin institucional të integritit të imigrantëve – kryesisht shqiptarë – në Greqi pengohen nga qëndrimi diskriminues dhe i anshëm i shumë autoriteteve shtetërore kundrejt shqiptarëve, çka nuk është në përputhje me një shtet të së drejtës. Një mbrojtje sistematike dhe e gjithanshme e të drejtave të shqiptarëve është e nevojshme për të ndihmuar kapërcimin e këtij deficieti demokratik në Greqi.

5. KZZ-të a do ngrihen në 3 Mars 2005?!

Tirane 18 shkurt 2005

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) si një nga organizatat monitoruese të zgjedhjeve periodike në Shqipëri, ndjek me vëmendje edhe përgatitjet për zgjedhjet parlamentare të këtij viti.

KSHH shpreh veçanërisht shqetësimin e tij që Kuvendi i Shqipërisë nuk ka miratuar ende ndarjen e zonave zgjedhore. Si rrjedhim, që tani është vështirësuar dhe ndoshta është bërë e pamundur ngritja në afatin e caktuar ligjor të komisioneve të zonave zgjedhore (KZZ-ve) që sipas nenit 34 të Kodit Zgjedhor duhet të ngrihen jo më vonë se 6 muaj para mbarimit të mandatit të Kuvendit” d.m.th. në 3 Mars 2005.

Deri në 3 Mars 2005 mbeten 14 ditë. Projektligji për ndarjen e zonave zgjedhore nuk i është paraqitur ende Kuvendit të Shqipërisë. **KSHH mendon se edhe sikur ky ligj të miratohet nga Kuvendi me procedure të shpejtuar, afati ligjor për ngritjen e komisioneve të zonave zgjedhore do të shkelet.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit arrin në këtë përfundim duke u bazuar në argumentat e mëposhtëm:

Së pari, komisioni i Zonës Zgjedhore emërohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në bazë të propozimeve që do të paraqesin partitë politike përkatëse. Partitë politike duhet të kenë parasysh papajftueshmërinë dhe kushtet ligjore që kërkon ligji për të qenë anëtar dhe sekretar i KZZ-së (nenet 34/1 dhe 34/2 të Kodit Zgjedhor;

Së dyti, KQZ-ja emëron anëtarët e KZZ-së jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e propozimeve, kur konstaton se propozimi është në përputhje me kërkesat e ligjit.

Së treti, brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimeve, KQZ-ja duhet të verifikojë një e nga një 700 anëtarë dhe 100 sekretarët e KZZ-ve.

Çdo formalizëm ose nxitim i tepruar në këtë drejtim mund të lejonte emërimet në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor. KSHH-ja ka parasysh gjithashtu se, sipas rekomandimit të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të

Venecias, trajnimi i anëtarëve duhet të kryhej **“jo më vonë se 180 ditë para zgjedhjeve”** (Rekomandimet, përkthim shqip faqe 5).

Për të gjithë është e qartë se **vonesa në ngritjen e KZZ-ve do të shkaktojë vonesa në trajnimin e tyre**, në përfundim të të cilit, sipas rekomandimeve të mësipërme **“duhet të bëhet testimi i tyre dhe ata individë që marrin një rezultat të kënaqshëm do të “çertifkohen” si administratorë të zgjedhjeve”**.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se **ngritja dhe trajnimi me vonesë i KZZ-ve mund të shoqërohet me pasojë të dëmshme dhe do të ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e zgjedhjeve.**

KSHH-ja mendon se realizimi i detyrës për të zhvilluar zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakontestueshme kërkon jo vetëm vullnet politik, por edhe zbatim rigoroz të Kodit Zgjedhor.

Është kjo arsyeja që KSHH-ja e sheh të nevojshme t’u bëjë thirrje partive politike dhe sidomos dy partive më të mëdha që në interes të vendit, të respektimit të Kushtetutës dhe të ligjit, të arrijnë konsensusin për ndarjen e zonave zgjedhore.

KSHH i sugjeron gjithashtu Kuvendit të Shqipërisë që të kërkojë paraqitjen sa më parë për miratim të projektligjit për ndarjen e zonave zgjedhore.

6. Më shumë tolerancë dhe respekt ndaj njëri - tjetrit

21 Mars 2005

21 Marsi është Dita Ndërkombëtare kundër Racizimit dhe Diskriminimit Racial. Në kuadër të kësaj dite, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, si organizata e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sensibilizimit të publikut përshëndet:

- Frymën e tolerancës dhe mirëkuptimit **ndërmjet shtetasve që i përkasin grupeve të ndryshme sociale, etnike, kombëtare si dhe besimeve të ndryshme fetare.**
- Zhvillimet pozitive të legjislacionit shqiptar në drejtim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut **në përgjithësi** dhe të minoriteve **dhe grupeve më të riskuara në veçanti.**
- Reformën ligjore **në drejtim të parandalimit të diskriminimit racial dhe formave të tjera të diskriminimit.**
- Reformën institucionale **të ndërmarrë dhe miratimin e strategjisë kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom në Shqipëri”.**
- Frymën e tolerancës së treguar në median shqiptare.
- **Përpjekjet që bëhen për të përmirësuar frymën e mirëkuptimit dhe respektimit reciprok të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri dhe të shtetasve shqiptar në vendet fqinje.**

Por me gjithë progresin e bërë gjatë këtyre viteve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreh mendimin e vet se:

- Situata ekonomike dhe sociale **e disa grupeve të veçanta në shoqërinë shqiptare dhe** sidomos i komunitetit rom dhe egjiptian **vazhdon të jetë** e vështirë.
- Pjesëmarrja e përfaqësuesve të këtyre komunitete **në zbatimin e strategjive të ndryshme** është relativisht e ulët;
- Arsimimi i fëmijëve të këtyre grupeve sociale, formimi profesional **dhe** punësimi i popullsisë rome dhe egjiptiane nuk është i kënaqshëm;
- Pjesëmarrja e tyre në jetën publike **gjithashtu** është e pakët;

Në kuadër të kësaj date, KSHH-ja sjell në vëmendje të publikut dhe të institucioneve shtetërore **faktin se** Komisioni Europian kundër Racizimit dhe Intolerancës (ECRI) është i shqetësuar lidhur me paragjykimet dhe stereotipet **për kategori të veçanta të shoqërisë në shumë vende të Europës si romët/jevgjit, azilkërkuesit dhe emigrantët, ndaj të cilëve vërehen shfaqje të ksenofobisë dhe të racizimit.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon që:

- Qeveria shqiptare të krijojë kushte më të mira për përfaqësuesit e minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian **jo vetëm** për një pjesëmarrje aktive në hartimin e strategjive për përmirësimin e kushteve të tyre në shoqëri, **por edhe** në drejtim të marrjes së masave konkrete për zbatimin e strategjive përkatëse.
- Strategjia kombëtare **për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve** të shoqërohet me planifikimin e buxheve të nevojshme dhe të mjaftueshme për zbatimin e saj.
- **Duke qënë se viti 2005, është viti europian i qytetarisë nëpërmjet edukimit** qeveria shqiptare dhe strukturat përgjegjëse të rrisin përpjekjet lidhur me arsimimin e fëmijëve në përgjithësi, por atyre rom dhe egjiptian në veçanti.
- **Qeveria Shqiptare** të vazhdojë të punojë për respektimin dhe mbrojtjen më të mirë të interesave të emigrantëve shqiptarë **në vendet ku ata jetojnë dhe punojnë.**
- Legjislacioni shqiptar të vazhdojë të plotësohet dhe të përmirësohet **me qëllim që të parandalojë dhe të dënojë çdo lloj diskriminimi direkt ose indirekt që mund t’u bëhet personave të veçantë.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se partitë politike mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Në hartimin e programave të tyre, ata të përfshijnë edhe çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të grupeve më të riskuara nga diskriminimi i drejtëpërdrejtë ose i fshehtë.

7. DËNOJMË RRUGAÇËRINË VANDALE DHE KSENOFOBE

30 Mars 2005

Sipas njoftimeve të shtypit, në ndeshjen e futbollit të datës 29 Mars 2005 që u zhvillua në Athinë midis skuadrave të futbollit të Greqisë dhe Shqipërisë, **ndodhën incidente që u shoqërua me parrulla antishqiptare duke arritur deri atje sa në mënyrë publike të digjej, grisej apo hiqej simboli i shtetit tone: Flamuri Shqiptar.**

Provokatorë të këtij fenomeni të përsëritur ishin grupet ekstremiste greke me ndjenja të theksuara ksenofobe që synojnë të çenonjë klimën e miqësisë midis vendit tonë dhe Greqisë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) e denoncon fuqishëm këtë akt vandal të shovinizmit ekstrem me doza të theksuara fashiste dhe kërkon që fajtorët të vihen para përgjegjësisë ligjore. Është e vërtetë se pas asaj që ndodhi, policia greke ndaloi apo arrestoi në flagrancë ndonjë person, por KSHH mendon se detyra kryesore ishte të parandalohet kjo ngjarje e hidhur dhe e dënueshme.

KSHH nuk pajtohet me faktin që ndërsa tifozët shqiptarë emigrantë në Greqi privohen për të marrë bileta si të gjithë të tjerët, për të ndjekur ndeshjen, nazis kinët e rinj, të prirur për të ngjallur urrejtje ndaj shqiptarëve lejohen të ndjekin ndeshjen dhe të ndërmarrin veprime ekstreme të dënueshme edhe nga opinioni i shëndoshë grek.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit shpreh konsideratën e tij për atë pjesë të mediave greke, të disa intelektualëve greke si dhe Federatës Greke të Futbollit që dënuan menjëherë aktin e mësipërm.

KSHH, me këtë rast i drejtohet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe posaçërisht Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë që të ndërhyjë pranë autoriteteve përkatëse greke duke kërkuar që fajtorët të ndiqen me përparësi duke marrë masa që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Rasti i fundit tregoi në mënyrë të hapët dhe bindëse se provokatorë nuk janë shqiptarë por grupe të caktuara me tendenca të theksuara ksenofobe që duan të pengojnë marrëdhëniet e miqësisë midis dy vendeve.

KSHH u bën thirrje gjithashtu organizatave joqeveritare greke të angazhuara në fushën e mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut të reagojnë ndaj akteve të tilla duke kontribuar kështu në krijimin e klimës së bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis popujve tanë.

8. Fjala përshëndetëse - Tryeza e rumbullakët

Tiranë, 2 mars 2005

Në kuadër të sensibilizimit dhe të përgatitjes për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja) e quajti të nevojshme organizimin e kësaj tryeze të rumbullakët me përfaqësues të disa OJF-ve, institucioneve shtetërore si edhe me specialistë të ndryshëm. Siç dihet, ndryshimet e Kodit Zgjedhor kanë qënë të shumta, për rrjedhojë njohja e tyre është e domosdoshme.

Gjatë kësaj periudhe, KSHH-ja ka ndjekur me vëmendje të veçantë punën e bërë për hartimin dhe miratimin e këtyre ndryshimeve, të cilat, kryesisht, janë bazuar në rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias. Që gjatë zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2003, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka patur vërejtje për Kodin Zgjedhor të vitit 2003. Këto vërejtje u bënë publike me deklaratë, letra dhe në një opionencë të plotë të Kodit Zgjedhor, e cila u botua në shqip dhe në anglisht dhe iu shpërnda gjithë institucioneve të interesuara, vendase dhe të huaja²⁴ si dhe përfaqësuesve të partive politike që u angazhuan në procesin e reformës zgjedhore. Për disa çështje që kanë të bëjnë me respektimin e Kushtetutës së RSH-së, KSHH-ja ka vënë në dijeni edhe Komisionin Dypalësh Parlamentar si edhe Komisionin Parlamentar për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore, pranë Kuvendit të Shqipërisë.

KSHH-ja disa herë është prononcuar publikisht për vonesat në përgatitjet e zgjedhjeve të sivjetshme parlamentare; KSHH-ja mëse një herë ka reaguar publikisht për ngadalësinë e Komisionit të Reformës Zgjedhore; për vonesat lidhur me përbërjen e KQZ-së dhe tash së fundi edhe për problemin e ndarjes së zonave.

Në datën 14 shkurt 2005 duhej të ishte miratuar ndarja e zonave zgjedhore. Më datë 3 mars 2005, domethënë nesër duhet të përfundojë krijimi i komisioneve të zonave zgjedhore. Por siç dihet, afatet e mësipërme nuk janë respektuar dhe nuk do të respektohen. Në këtë drejtim, kritika të ashpra, por të drejta u bënë edhe nga përfaqësuesit e BE-së gjatë negociatave që Qeveria Shqiptare bëri në kuadër të Asocim-Stabilizimit në muajin shkurt 2005.

Mbas miratimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe ndarjes së zonave zgjedhore, detyra të rëndësishme dalin për zbatimin e tyre. Ky proces kërkon konsensus partiak dhe vullnet politik. Por krahas kësaj, kërkohet gjithashtu edhe zbatim rigoroz i atyre dispozitave që partitë kanë miratuar vetë.

²⁴ Personat e interesuar mund ta lexojnë në adresën: www.ahc.org.al

Aktualisht detyra kryesore është hartimi i listave të zgjedhësve, shpallja dhe korigjimi i tyre. Urgjente është krijimi i komisioneve zgjedhore të zonave. Fill pas kësaj, rëndësi të veçantë merr trajnimi i komisionerëve, paraqitja e kandidaturave, etj. Në qoftë se secili organ dhe secili person do të kryejë detyrën e tij, ky proces shpresojmë të jetë normal.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe OJF-të e tjera janë jo vetëm të interesuara për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, por edhe të angazhuara për të dhënë kontributin e tyre modest në këtë fushë. Edhe kjo tryezë njohjeje që organizojmë sot i shërben këtij qëllimi.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të angazhohet në vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005 dhe do të japë gjithashtu ndihmën e tij që ky proces të monitorohet me kujdes, megjithëse, për shkak të ndryshimeve që i janë bërë nenit 18 të Kodit Zgjedhor, sfera e monitorimit është ngushtuar. KSHH-ja do të vazhdojë të ndjekë me vëmendje hapat e mëtejshme që do të merren në drejtim të përgatitjes për zgjedhjet parlamentare dhe do të reagojë ndaj çdo zvarritje ose shkeljeje që mund të çojë në cënim të procesit të ndershëm, të lirë dhe demokratik të zgjedhjeve.

Nga ana tjetër, do të desha të sillja në vëmendjen tuaj se kanë kaluar një muaj e 20 ditë nga data e miratimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe për njohjen e tyre mendojmë se është bërë pak: një emision në Televizionin kombëtar Arbëria, një shkrim në gazetën "Korrieri" dhe kjo tryezë e rrumbullakët që organizohet sot.

Nëqoftëse kjo detyrë do t'i lihet vetëm Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, që në fakt është tepër i ngarkuar, edukimi zgjedhor i shtetasve do të jetë i mangët dhe i kufizuar dhe votuesit nuk do të jenë në gjendje të përdorin siç duhet të drejtën e votës. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar, se sipas Kodit zgjedhor, me detyra të tilla ligji ngarkon disa organe dhe institucione të tjera (jo vetëm organet e qeverisjes vendore).

Është pikërisht kjo arsye që nxiti KSHH-në të organizojë këtë tryezë të rrumbullakët. Kjo tryezë mund të konsiderohet hapi ose nisma e parë për një njohje më të thellë të Kodit Zgjedhor të miratuar, pse jo edhe në kuadrin e edukimit ligjor të shtetasve.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ngarkuar z. Niazi Jaho, këshilltar ligjor i këtij Komiteti për të bërë të njohur disa nga ndryshimet kryesore të Kodit Zgjedhor. E shikojmë të nevojshme të theksojmë se KSHH-ja ngarkoi z. Niazi Jaho, si një nga njohësit e kësaj fushe. Në këtë vështrim, mendimet ose qëndrimet e tija për çështje të caktuara nuk janë detyruesisht edhe qëndrimet e KSHH-së.

Dhe së fundi për nga rradha, por ja nga rëndësia, dëshiroj të theksoj se problemet objekt diskutimi në këtë tryezë do të trajtohen në vështrimin ligjor. Në këtë tryezë nuk jepen përfundime dhe as konsiderata të KSHH-së. Pyetjet dhe diskutimet në këtë tryezë do të ndihmojnë për një kuptim më të drejtë të disa çështjeve që përmban Kodi Zgjedhor.

Edhe njëherë do të desha t'ju falenderoja për pjesëmarrjen tuaj në këtë tryezë.

8. Letër e hapur - Tiranë, më 3 Mars 2005

Drejtuar: Z. Servet Pëllumbi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë
Kuvendi i Shqipërisë

Nga: Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
Qendra për Studime Parlamentare
Shoqata për Kulturë Demokratike
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut

Lënda: **Propozim për ndryshimin e nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor**

I nderuar Z. Pëllumbi,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit në datën 2 Mars 2005, organizoi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të OJF-ve, të disa institucioneve shtetërore si edhe me specialistë të fushave të ndryshme. Qëllimi i kësaj tryeze ishte njohja e disa prej ndryshimeve që i janë bërë Kodit Zgjedhor me ligjin Nr. 9341, datë 10.1.2005.

Në këtë takim disa përfaqësues të OJF-ve shprehën shqetësimin lidhur me përmbajtjen e nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor, ku bëhet fjalë për ngritjen e grupeve të numërimit të votave. Në këtë dispozitë thuhet: "Për

numërimin e votave në rang njësie zgjedhore, me vendim të KZZ-së ose KZQV-ve, jo më vonë se dy orë para mbylljes së votimit ... caktohen deri në 5 grupe numërimi dhe një sekretar për secilin”. Në po këtë dispozitë theksohet se: “Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe sekretari i grupit të numërimit caktohen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara për KZZ-të...”.

Përfaqësuesit e OJF-ve të pranishme në këtë tryezë mbasi e diskutuan këtë çështje vendosën t'i drejtohen Kuvendit të Shqipërisë me sugjerimin për ndryshimin e nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor duke parashtruar argumentat e mëposhtme:

1. Nëqoftëse grupet e numërimit të votave do të ngrihen jo më vonë se dy orë para mbylljes së votimit (ashtu siç parashikohet në ligj) trajnimi i anëtarëve do të ishte tepër i vështirë për të mos thënë i pamundur ose do të kryhej një trajnim formal dhe jo cilësor, gjë që do të shoqërohej me pasoja të dëmshme.

2. Ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë afat deri kur partitë politike përkatëse duhet të bëjnë propozimet për anëtarë të këtyre grupeve. Vlen të përmendet se nëqoftëse çdo KZZ do të caktonte 5 grupe plus sekretarin e këtij grupi del që për 100 zonat do të duhen 4000 persona.

Në këtë drejtim, edhe në këto zgjedhje kemi përvojë negative. Kështu, në ligj thuhet se KZZ-të ngrihen jo më vonë se data 3 Mars 2005, ndërsa në fakt deri më sot partitë nuk kanë paraqitur propozimet e tyre.

3. Grupet e numërimit të votave ngrihen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara për KZZ-të që parashikohen në nenet 34, 34/1 dhe 34/2 të Kodit Zgjedhor, ndërsa KQZ-ja siç përmendet në pikën 5 të nenit 34 të Kodit, emëron anëtarët e KZZ-ve jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e propozimeve kur konstaton se ato janë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor.

Në këtë vështrim, jemi të shqetësuar edhe për faktin se KZZ-të nuk do të kenë mundësi të verifikojnë nëse anëtarët e grupeve të numërimit të votave dhe sekretarët e tyre i plotësojnë ose jo kriteret dhe kushtet e parashikuara në dispozitat e mësipërme. Mungesa e një verifikimi të tillë mund të shoqërohet gjithashtu me pasoja të dëmshme.

Janë pikërisht arsyet e mësipërme që përfaqësuesit e disa OJF-ve e panë të arsyeshme t'i drejtohen Kuvendit të Shqipërisë që të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të pikës 1 të nenit 95 të Kodit Zgjedhor si më poshtë: “Me numërimin e votave në rang njësie zgjedhore me vendim të KZZ-së ose KZQV-së caktohen deri në 5 grupe numërimi me shtatë anëtarë dhe një sekretar secili. Çdo grup numërimi numëron votat e të paktën 3 qendrave të votimit. Propozimet për anëtarë të grupeve nga partitë politike përkatëse bëhen jo më vonë se 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, ndërsa vendimi për caktimin e tyre, KZZ-të e marrin brenda 10 ditëve nga paraqitja e propozimeve”.

Nisur nga dëshira për mbarëvatjen e procesit zgjedhor duke e konsideruar numërimin e votave si një moment mjaft të rëndësishëm dhe delikat, shprehim paraprakisht besimin se sugjerimi ynë do të bëhet objekt shqyrtimi.

Me respekt të veçantë:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
Qendra për Studime Parlamentare
Shoqata për Kulturë Demokratike
Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut